REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TE QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 5860
Nr. i faq. Br. str. 7 Data: Datum: 12/03
KAMENICË/A 2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

| | |
|---|---|
| **Për** | **Zyrën Kombëtare të Auditimit** |
| **Kopje** | **Kryesuesi I Kuvendit Komunal Kamenicë** |
| **Nga** | **Kryetari i Komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj** |
| **Datë** | **15 mars 2025** |
| **Viti raportues** | **2023** |

**RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit**

Në bazë të nenit 14, pika 5 e Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve te veprimit, në fuqi që nga qershori 2019, ku thuhet se: *Pas hartimit të planit të veprimit, entiteti I audituar i dorëzon Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit/aksionarit raporte lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve. Raportet dorëzohen dy here në vit, respektivisht deri më 30 shtator dhe 15 mars.*

Prandaj, në përgjigje të kësaj kërkese, Komuna e Kamenicës ka përgatitur këtë raport lidhur me progesin e zbatimit të rekomandimeve që dalin nga Raporti I Auditimit.

I njëjti dokumet i dërgohet Kryesuesit të Kuvendit Komunal për ta vendos në rend të ditës për mbledhjen e ardhshme.

**Mars, 2025**

**RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE, KOMUNA E KAMENICËS**

**Raportimi për afatin 15 mars 2025**

| Nr | Komponenta e auditimit | Gjetja | Rekomandimi | | Statusi i rekomandimit( i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar) | Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Çështja A1 - Nënvlerësimi i detyrimeve kontigjente** | Neni Bazuar në nenin 18 të Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore përcaktohet se: "Organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente". Nga analiza e PVF-ve kemi vërejtur se raportimi i detyrimeve kontigjente në PVF nuk ishte i plotë dhe i saktë, pasi që ishin nënvlerësuar për 42,689€. Në një rast kemi vërejtur se komuna nuk kishte shpalosur në PVF një detyrim kontigjent ndaj një të punësuari në QKMF në vlerë prej 21,594€. Gjithashtu në 11 raste të tjera, vlera në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe shpalosur në PVF ishte gjithsejt 21,21€, ndërsa duhej të ishte 21,117€. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës. . | Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. | Do te harmonizohen shenimet e saktesise te raporteve te detyrimeve Kontigjente gjate pregaditjes te PVF per vitin 2024 ndermejt Avokatit te Komunes dhe ZKF | I zbatuar | Nuk kapatur sfida të theksuara. |
| 2 | Çështja B1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve | Neni 22.3 i Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare thotë se: "Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale | .Kryetari, duhet të sigurohet që | Janë bërë azhurimet e rexhistrit të pasurive jo kapitale me vlerë nën | I zbatuar | Nuk ka pasur sfida |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit".<br><br>Kemi evidentuar se vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) e prezantuar në PFV ishte mbivlerësuar për 211,210€. Përkatësisht, vlera neto e paraqitur në PFV është 414,351€, përderisa vlera neto e pasurive jo kapitale në sistemin E-Pasuria është prej 203,141€.<br><br>Sipas zyrtarëve komunal, kjo gjendje ishte për shkak të problemeve teknike me sistemin E-Pasuria i cili nuk ka bërë zhvlerësimin e pasurive, çështje kjo e rregulluar vetëm pas datës së përgatitjes/korrigjimit të PFV-ve për vitin 2022. | do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive jo kapitale për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar dhe prezantuar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale | (1,000.000) | | |
| 3 | Çështja C1 - Mos regjistrimi i plotë i pasurive jo financiare | Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6 paragrafi 1 përcakton se: Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Nga testimet tona kemi vërejtur se në sistemin e E-pasurise ishin të regjistruara mbi 3,217 njësi të pasurive jo financiare (nën 1,000€), ndërsa bazuar në raportin e inventarizimit përmbante mbi 60,000 njësi të cilat nuk ishin të regjistruara në E-pasuri. Këto pasuri janë kryesisht inventaret e QMF-ve dhe shkollave. Për më tepër në raportin e SIMFK të pasurive jo financiare mbi 1,000€, kemi vërejtur regjistrimi të përgjithësuara me përshkrimin e pasurisë pa përcaktim të lokacionit si (asfaltimi | Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet vlerësimi i pasurive jo financiare për të azhurnuar regjistrin të pasurive për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar në plotëni dhe saktësi në | Janë marrë të gjitha masat e nevojshme për harmonizimin e E-pasurisë .Është formuar komisioni për vlerësimin e Pasurisë jo financiare me vlerë nën 1,000.00€. | Në proces | Është në proces të përfundimit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | i rrugëve lokale, kanalizime në qytet e fshatra, toka etj.), në rastin e tokave nuk na është ofruar një raport i vlerësimit të brendshëm për regjistrimit e 94 njësive në vlerë 43,413,511€. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo efektive në procesin e evidentimit raportimit dhe monitorimit të pasurive jo financiare nën 1,000€ në sistemin e E-pasurisë, ndërsa pasuritë mbi 1,000€ janë regjistruar në mënyrë të përgjithësuar është si pasojë e regjistrimeve totale të pagesave/projekteve e jo në njësi të veçanta të pasurive. | regjistrat përkatës të pasurive komunale | | | |
| 4 | Çështja B2 - Angazhimi i stafit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta dhe kontrata për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta të punës | Ligjit Nr. 06/L-0114 për zyrtarët publik, nenit 84, përcakton se "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik". Përderisa neni 59 i RRUOPP ka përcaktuar qëllimin dhe procedurën e prokurimit publik lidhur Marrëveshjet për shërbime të veçanta. Përkatësisht, neni 59.1 ndër të tjera definon "shërbimet konsulente"– të cilat nënkuptojnë një shërbim të një natyre intelektuale apo konsultative, që furnizohet nga një konsulent ekspert dhe i kualifikuar në një fushë të caktuar apo profesion dhe përfshinë shërbime ku aspektet intelektuale dhe kontributet mbizotërojnë dhe tejkalojnë aspektet tjera fizike të kontratës. Po ashtu, neni 10.6 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 thotë se: "Kontrata për një detyre specifike, nuk mund të jetë me e gjatë se 120 dite brenda një (1) viti. Komuna kishte angazhuar 32 punonjës përmes "Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV)", prej tyre tetë (8) ishin angazhuar përmes procedurave të prokurimit, ndërsa 24 me procedurë të thjesht të rekrutimit pa i | Kryetari duhet të sigurojë se për pozita të rregullta të punës angazhohet staf i rregullt përmes procedurave të rekrutimit dhe se procedurat e prokurimit për angazhimin e stafit për shërbime të veçanta si dhe kontratat për punë dhe detyra specifike, aplikohen | Do te angazhohemi qe te respektojm rekomandimin, por te gjitha pozitat te cilat jane angazhuar jane ato per pune dhe detyra specifike per te ofruar efiksitet dhe fleksibiltet ne kryrjen e puneve dhe me qellim qe te mos kete ngecje ne pune dhe per shkak te planit dhe afateve te procedurave rekrutuese dhe ne disa raste nuk mund te kufizohemi por duhet t`i perdorim per zgjidhje alternative. | Në proces | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | respektuar procedurat e prokurimit publik. Punonjësit janë angazhuar për pozita të rregullta të punës dhe jo për shërbime të veçanta apo detyra specifike, siç kërkohet me ligj. Për më tepër në 20 raste kohëzgjatja ishte nga 5 (pesë) deri në 12 muaj, duke tejkaluar afatet e përcaktuara ligjore (120 ditë brenda vitit 2023). Kontratat ishin lidhur me personat njëjtë dhe për pozitat e njëjta dy deri tre herë. Për këta punonjës komuna në vitin 2023 kishte paguar 77,073€. Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së pozitave të aprovuara të vendeve të punës më ligjin për buxhetin e RK-së. | vetëm për pozita specifike dhe të veçanta të cilat nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm i komunës. | | | |
| 5 | Çështja A2 - Kontraktimi me OE për projektin që mund të kryhej nga institucioni publik | Udhëzimi Administrativ UA nr. 02/2012 për klasifikimin e përshtatshmërisë se tokës bujqësore, neni 8 paragrafi 3 përcakton se: Vlerësimi do të behet nga një institucion i autorizuar i MBPZHR. Po ashtu, Ligji Nr. 04/L-42 për prokurimin publik, nenin 9 paragrafi 4, taksativisht normon se Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik. Komuna kishte nënshkruar kontratat me OE (konsorcum) në vlerë 328,781€ për projektin „Inventarizimi i tokave në Komunën e Kamenicës''. Përkundër faktit që ku projekte të kësaj natyre mund të realizohen nga MBPZHRInstituti Bujqësor i Kosovës. Për më tepër, komuna nuk kishte bërë kërkesës zyrtare IBK-së për realizimin e këtij projekti. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së informacioneve të mjaftueshme nga zyrtaret komunal mbi detyrimet dhe përgjegjësit që | Kryetari duhet të siguroj para çdo aktiviteteti të prokurimit që për projektet të cilat mund të kryhen nga autoritetet publike të zbatohet neni 9 paragrafi 4 i LPP-së | Ky projekt eshte realizuar dhe nuk planifikohet te kete aktivitetet e ngjajshme per periudhe afateshkurter . | I zbatuar | Në planin afatëmesëm nuk do të ketë projekte të ngjashme |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | autoriteti publik (IBK) ka për të siguruar kryerjen e projekteve të kësaj natyre. | | | | |
| 6 | Çështja A3 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të pronave të paluajtshme | Ligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 15 pika 2, përcaktohet se "Komuna çdo vit inspekton të paktën njëzet për qind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese mund të angazhojë edhe inspektorë privat." Komuna në vitin 2023 për tatimin në pronë të objekteve në sistemin Protax kishte të regjistruar 15,562 objekte. Ne kemi vërejtur se komuna nuk kishte arritur të bënte inspektimin (verifikimin) e 20% pronave të paluajtshme siç kërkohet nga ligji në fuqi, por kishte verifikuar vetëm 1,120 pronave të paluajtshme apo 7.2%. Mos verifikimi i pronës ka ndodhur për shkak të mungesës të anketuesve në terren për verifikim të pronave të paluajtshme. | Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme siç kërkohet me ligj | Per vitin 2024 jane marre masat e duhura dhe eshte bere mobilizimi i zyrtareve ne teren dhe shpresojm se deri ne fund te vitit te arrihet rianketimi prej 20% te pronave . | I zbatuar | Nr. I objekteve per verifikim per vitin 2024 ka qenë 2771,<br><br>Janë rianketuar 2970 objekte për vitin 2024 |
| 7 | Çështja A4 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë | Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 dhe 11.4 4, përcakton se: Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. UA nr. 03/20211 për mbledhjen dhe regjistrimin e informative | Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal për tu deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me | Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor. | I zbatuar | Janë rexhistruar dhe validuar nr. Personal sipas listes se derguar nga DTP. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mbi pronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1 kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik.Në raportin financiar të objekteve janë identifikuar 614 tatimpagues që nuk kanë numër personal, për të cilët është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.Kjo ka ndodhur për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë, ku nuk është arritur që të azhurnohen të dhënat në Protax. | përllogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra. | | | |
| 8 | Çështja B3 - Mos harmonizimi i raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive | Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19 paragrafi 4.3 përcakton se; Krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.<br>Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar më gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.<br>Mangësitë në procesin e inventarizimit, kryesisht ishin për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare. | Mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë. | Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat. | I zbatuar | |

KOMUNA E KAMENICËS

**2024-2028**

**Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM)**









*Fjala e Kryetarit të Komunës*

Të dashur qytetarë,
Kam kënaqësinë të ndaj me ju një nga iniciativat më të rëndësishme për të ardhmen e komunës sonë – Planin e Veprimit Lokal për Mjedisin.

Ky plan është rezultat i një përkushtimi të përbashkët, punës së palodhur dhe vizionit tonë për një mjedis më të pastër, më të gjelbër dhe më të shëndetshëm për të gjithë.

Mjedisi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës sonë, në shëndetin e fëmijëve tanë dhe në mirëqenien e brezave që do të vijnë. Prandaj, është detyra jonë ta mbrojmë dhe ta zhvillojmë atë me kujdes dhe përgjegjësi.

Plani i Veprimit Lokal për Mjedisin përmban një sërë masash konkrete që synojnë përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, përforcimin e gjelbërimit urban, reduktimin e ndotjes dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme.
Këto masa nuk janë vetëm ambicie, por janë angazhime që do të zbatohen me mbështetjen e të gjithë akterëve të përfshirë siç janë institucionet lokale, bizneset, OShC-të dhe para së gjithash qytetarët e komunës sonë.

Jam i bindur se me bashkëpunim, transparencë dhe vendosmëri, do të arrijmë ta transformojmë mjedisin tonë në një model të qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të gjithëmbarshëm.

Së bashku, mund të ndërtojmë një të ardhme më të gjelbër dhe më të shëndetshme për komunën tonë dhe për brezat që vijnë pas nesh.

Sinqerisht,
*Kryetari i Komunës*
**Kadri Rahimaj**

Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

**Zyra e Kryetarit - Komuna e Kamenicës**

Anëtarët e Trupit Koordinues:

1. Kadri Rahimaj -Kryetar i Komunës
2. Ibrahim Kastrati -(DSHPAI)- Kryesues
3. Fisnik Kastrati - (DAP)-Anëtar
4. Shefik Rrudhani - (DKA)- Anëtar
5. Bektesh Dërmaku -(DBPZHR)- Anëtar
6. Edon Dërmaku -(DZHED)- Anëtar
7. Shaban Canaj -(DMSH)- Anëtar
8. Arben Hoxha -(DFB) - Anëtar
9. Ilirida Zubaku -(DPGJK) – Anëtare
10. Besart Fejzullahu -(DUPH)- Anëtar

**Baza Ligjore për Hartimin e PVLM-së**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 9538
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 26/03
KAMENICË/A 2024

Zyra e Kryetarit
Sh.02.Nr.126/ dt.26.03.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.03/L-025 për mbrojtje të mjedisit, nenit 70 të Statutit Sh.01.Nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komuunës së Kamenicës, merr këtë:

**VENDIM**

1. Miratohet Vendimi për caktimin e komisionit për hartimin e dokumentit "Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024 – 2028" në Komunën e Kamenicës.

2. Anëtarët e Komisionit të cekur në pikën (1) një të këtij Vendimi janë:

   **2.1** Ibrahim Kastrati (DSHPAI), Kryesues;
   **2.2** Fisnik Kastrati (DAP), Anëtar;
   **2.3** Shefik Rrudhani (DKA), Anëtar;
   **2.4** Bektesh Dërmaku (DBPZHR), Anëtar;
   **2.5** Edon Dërmaku (DZHED), Anëtar;
   **2.6** Shaban Canaj (DMSH), Anëtar;
   **2.7** Arben Hoxha (DFB), Anëtar;
   **2.8** Ilirida Zubaku (DPGJK), Anëtare; dhe
   **2.9** Besart Fejzullahu (DUPH), Anëtar.

3. Detyrë e Komisionit është hartimi i dokumentit "Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024 – 2028", në afat prej 90 ditëve nga data e pranimit të vendimit.

4. Për kryerjen e detyrës si në pikën (3) të këtij Vendimi, Komisioni i Raporton Kryetarit të Komunës.

5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

***Vendimi t'i dërgohet:*** *Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivit.*

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 9538
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 26/03
KAMENICË/A 2024

**Zyra e Kryetarit**
**Sh.02.Nr.126/ dt.26.03.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.03/L-025 për mbrojtje të mjedisit, nenit 70 të Statutit Sh.01.Nr.20203 i datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komuunës së Kamenicës, merr këtë:

**VENDIM**

1. Miratohet Vendimi për caktimin e komisionit për hartimin e dokumentit "Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024 – 2028" në Komunën e Kamenicës.

2. Anëtarët e Komisionit të cekur në pikën (1) një të këtij Vendimi janë:

   **2.1** Ibrahim Kastrati (DSHPAI), Kryesues;
   **2.2** Fisnik Kastrati (DAP), Anëtar;
   **2.3** Shefik Rrudhani (DKA), Anëtar;
   **2.4** Bektesh Dërmaku (DBPZHR), Anëtar;
   **2.5** Edon Dërmaku (DZHED), Anëtar;
   **2.6** Shaban Canaj (DMSH), Anëtar;
   **2.7** Arben Hoxha (DFB), Anëtar;
   **2.8** Ilirida Zubaku (DPGJK), Anëtare; dhe
   **2.9** Besart Fejzullahu (DUPH), Anëtar.

3. Detyrë e Komisionit është hartimi i dokumentit "Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024 – 2028", në afat prej 90 ditëve nga data e pranimit të vendimit.

4. Për kryerjen e detyrës si në pikën (3) të këtij Vendimi, Komisioni i Raporton Kryetarit të Komunës.

5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

***Vendimi t`i dërgohet:*** *Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivit.*

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

# Përmbajtje

Hyrje .......... 9
Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së .......... 10
Pozita Gjeografike e Komunës së Kamenicës .......... 11
Kushtet Fiziko-Gjeografike .......... 11
Kushtet klimatike .......... 12
Hidrografia .......... 13
Flora dhe Fauna .......... 14
Zonat e Mbrojtura .......... 17
Rreziqet Natyrore .......... 17
Thatësira .......... 18
Vërshimet .......... 18
Kushtet Socio-Ekonomike .......... 20
Ndarja administrative .......... 20
Popullsia .......... 20
Trashëgimia kulturore .......... 23
Bujqësia .......... 24
Industria .......... 25
Turizmi .......... 27
Transporti .......... 28
Infrastruktura e energjisë elektrike .......... 30
Infrastruktura e ujësjellësit .......... 32
Infrastruktura e Ujërave të Zeza .......... 32
SWOT ANALIZA .......... 34
Peizazhet .......... 35
Argumente të Analizës SWOT .......... 36
Vizioni i Komunës së Kamenicës .......... 41
Koncepti i Zhvillimit Hapësinor i Kamenicës .......... 53

Shëndeti ........ 58

Biodiversiteti, Flora dhe Fauna ........ 64

Kritere të Forta Mjedisore-Shendetesore ........ 74

Kritere Peisazhike ........ 77

Komuna e Kamenicës dhe Zgjidhjet e Parashikuara përProblemet e Mjedisit ........ 86

Plani Zhvillimor ........ 87

Trajtimi i Qështjeve Mjedsore në Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal ........ 87

Analiza e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PLVM-së ........ 88

Masat e Nevojshme në PLVM për Mbrojtjen e Mjedisit ........ 103

Konceptet ........ 103

Ndikimi në klimë ........ 104

Mbrojtja e Pyjeve, Zonave të Gjelbra Ekzistuese dhe Zhvillimi i Zonave të Reja ........ 104

Cilësia e Ajrit ........ 105

Propozimet për Rrugë ........ 105

Probleme të Mjedisit në Kamenicë dhe Përgjigja që Jepet përmes PLVM-së ........ 110

Monitorimi ........ 144

Perfundime ........ 10

LITERATURA ........ 3

## Hyrje

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin. Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informa cionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në Nenin 24 të Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25 Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qellim të:

• Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcak timin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.

• Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të procesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.

• Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, har timin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan Veprimi.

• Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe mod eleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informa cion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.

• Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lid hur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbë sore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpër mjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

## Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Kamenicës u hartua përgjatë një periudhe tremujore dhe në hartimin e tij, janë përfshirë akterë të pushtetit vendorë dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune më specialistë të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë tjerë vendor dhe ndërkombëtarë për hartimin e PLVM. Së pari, është bërë trajnimi i grupit punues të cilët u ftuan në projekt në aspektet e hartimit të PLVM-së dhe gjetjes së mjeteve shtesë për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë mjedisore. Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Kamenicës. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve, të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin punues në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Kamenicës dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suk sesshëm. Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media. Dokumenti i është paraqitur Kuvendit Komunal të Kamenicës dhe është miratuar prej tij më 26.03.2024, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune. Procesi themelor i hartimit të PLVM-së ndahet në faza, të cilat lidhen njëra pas tjetrës:

a) Aprovimi nga Kryetari i Komunës së Kamenicës

b) Aktivitetet përgatitore;

c) Formimi i trupit koordinues TK;

d) Formimi i grupit punues GP;

e) Trajnimi i anëtarëve të GP;

f) Vizionimi i komunitetit;

g) Vlerësimi i gjendjes së mjedisit;

h) Anketimi i qytetarëve;

i) Caktimi i prioriteteve;

j) Hartimi i planit të veprimit për fushat prioritare dhe;

k) Caktimi i prioriteteve në realizimin e planit të veprimit.

Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:

1. Analiza e gjendjes mjedisore Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Kamenicës.

2. Lista e problemeve mjedisore Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

3. Plani i veprimeve për zgjidhje Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara. Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.
Të Dhënat e Përgjithshme për Kamenicën

## Pozita Gjeografike e Komunës së Kamenicës

Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës. Kufizohet në Jug-Perëndim me komunën e Ranillugut, në Perëndim me komunën Novobërdës si dhe në Veri-Perëndim me Prishtinën. Në Veri me Komunën e Medvegjës dhe Leskovcit, në Lindje me Vranjën dhe në Lindje dhe Jug-Lindje me Bujanocin. Sipërfaqja e Komunës së Kamnenicës është 417 km2. Pozita gjeografike e K.Kamenicës është periferike ne skajin me Lindor te Kosovës por është urë lidhëse ne mesë Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore kryesisht të banuara me shqiptar. Nëpërmjet magjistrales Gjilan -Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi 30 km, ndërsa Prishtina 75 km nga Kamenica. Me Prishtinën mund të lidhet edhe me rrugë më të shkurtër, nëpër Novobërdë dhe Llabjan, ku në të dy drejtimet rruga shkurtohet për 50-55 km. Stacioni më i afërt Hekurudhor është në Ferizaj dhe Bujanoc. Aeroporti më i afërt është ai i Prishtinës 90km dhe i Shkupit 130km. Si përfundim mund të themi se komuna e Kamenicës ka një pozitë shumë të përshtatshme gjeografike e cila i mundëson kësaj komune zhvillim të sigurt prosperues. Gjithashtu ky avantazh ka edhe efektet tjera mjedisore të cilat duhet të mirën në konsideratë në mënyrë që të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm në përgjithësi për komunën e Kamenicës.

## Kushtet Fiziko-Gjeografike

Hipsometria dhe topografia Territori i komunës së Kamenicës gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m e cila gjendet në pjesën e rrafshët do të thotë gjer në 600 m të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore. Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjendet një pjesë vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre. Në aspektin topografik të përthyeshmërisë së terrenit pjesa qendrore dhe kryesisht pjesa fushore ka topografi të but, ku ekuidistanca me dy izohypseve 10m është disa qindra metra, ndërsa pjesët lindore dhe perëndimore të komunës karakterizohet me përthyeshmëri të madhe të terrenit të përberë nga disa qindra rrjedhe ujore kryesisht të përkohshme.

**Gjeologjia dhe tokat**

Rajonin e gjerë të vendburimit e ndërtojnë këto njësi litologjike:

1. Rreshpet kristalore të grupit të parë
2. Formacionet terciare-miocene
3. Granite, pegmatite dhe aplite.

4. Tufet andezito-dacite

5. Mermerët dhe gëlqerorët e mermerizuar

6. Produktet e quaternarit ku Sipas të dhënave shifet se pjesa më e madhe e tokës përbëhet nga boniteti i klasës VI 46 %, pastaj klasa V dhe VII me 14%, kurse tokë më pjellore të klasit II ka 5%.

## Kushtet klimatike

Komuna e Kamenicës ka klimë të mesme kontinentale , me verëra të nxehta dhe dimëra të ftohtë. Temperatura mesatare e janarit është –1°C, ndërsa ajo e korrikut 21.50°C. Temperaturat maksimale apsolute janë në muajin gusht +37°C, kurse minimale absolute janë në janar –32 °C. Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m2. Lartësia më e ulët mbidetare është 380m te "Dheu i bardhë" , kurse ajo më e larta është 1223 m te " Guri i zi". (f.Tërsten) Lagështia e ajrit – vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84 %. Reshjet – Sasitë mesatare vjetore të reshurave në komunën e Kamenicës arrin 596l/m2, ndërkaq në zonën malore shtohen në 800 l/m2. Muajt më të pasur me shi janë nëntori dhe maji me 76.1 dhe 71.9 l/m2, kurse në viset malore muaji i dhjetorit me 101.0 l/m2. Muaji më i thatë është korriku dhe gushti. Erërat– Në komunën e Kamenicës erërat më të shpeshta janë ato veriore me dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me , kurse shpejtësia mesatare e erës është 3m/sek.




**Reshjet Atmosferike sipas IHMK**

**Lagështia relative e ajrit** ka vlerë mesatare vjetore 76,7% më muajin gusht më të thatë(68%) dhe me muajin më lagështi më të madhe janarin (86,1%).Sipas të dhënave të IHMK.

**Vranësirat dhe diellosja** në ketë regjion vrentësimi mesatar vjetor është 57% gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 57,9(15,9% nga viti) ,sipas të dhënave të IHMK Sipas pozitës gjeografike të këtij rajoni,

ndryshimet e elementeve dhe dukurive atmosferike janë në konditat normale të ndryshimit të shtypjes atmosferike për këtë rajon.

**Reshjet**, sasirat e të reshurave në këtë rajon janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë. Sasirat mesatare vjetore sillën rreth 673,3 mm në, sipas të dhënave të IHMK.[1]

## Hidrografia

Territor i Komunës së Kamenicës në tërësi i takon derdhjes së lumit Morava e Binçës dhe atë rrjedhës së mesme. Rrjeti hidrografik i kësaj rrjedhe të lumit Morava e Binçës është i zhvilluar në degët më të rëndësishme, për ketë analizë kemi shfrytzuar të gjitha të dhënat nga burimet e më parshme dhe kemi realizuar vizita të shtretërve të lumenjve dhe prrockave, në Komunën e Kamenicës : Berivojcë, Koretin, Topanicë, Hodonoc, Rogaqicë, Novosellë, Karaqevë e Epërme, Muçivercë, Dajkoc, Shipashnicë e Poshtme, Shipashnicë e Epërme, Velegllav, Laqiq, Kolloleq, Kopernicë, Hogosht, Hajnoc, Meshinë, Kremenat, Strezoc, Krilev , Kamenicë. Poashtu Komuna e Kamenicës është e pasur edhe me ujërat burimore që gjinden në lartësi mbidetari 1000 mld sic janë: Fabrika e Ujit në Bujnoc – Uji Kika, në Hogosht Uji Ari, në Gmicë Uji Crystal, Tërstenë Uji Guri I Zi, në Zajqec Uji Zajqeci, Kamenicë Fabrika në fazën finale rreth Fabrikës së Ujit – Uji Shkodra.

[1] VSM-PLVM-Kamenice-06.12.2019-1.pdf (rks-gov.net)

## Flora dhe Fauna













*Fotot marrur nga Fotografi i mirënjohur z.Arian Mavriqi* [2]

Pas hulumtimeve të bëra në fitodiversitetin e Kamenicës parashikohet që disa lloje të mbrohen ruhen dhe konservohen pasi që është konstatuar se ekzistojnë fitocenoza të cilat janë mjaft të begatshme dhe interesante në aspektin ekonomik, shkencor dhe mjekësor. Sa i përket zoodiversiteti, sipas të dhënave nga IKMN2, dhe analizave të ekipit punues territori i komunës së Kamenicës është i pasur me shtazë të egra në mesin e të cilave ka edhe lloje që konsiderohen si të rrezikuara dhe në ketë drejtim parashikohet mbrojtja e zonave ku jetojnë dhe veprojnë këto kafshë si dhe mbrojtja e tyre si specie. Edhe Kamenica si edhe shumica e vendeve të Kosovës po përballet me problemin e humbjes se biodiversitetit. Faktori kryesor qe ka shkaktuar kërcenim serioze për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore padyshim është faktori njeri, ndërkaq shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit dhe ujit dhe gjuetia e pakontrolluar janë vetëm disa nga faktorët tjerë qe vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë më të madhe ekosistemin natyror është një nga problemet me emergjent për natyrën e Kamenicës. Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur kryesisht si pasoje e shfrytëzimit pa kriter te zonave pyjore. Si pasoje e këtyre ndikimeve rrjedh edhe kërcënimi për zhdukje i shumë llojeve bimore dhe shtazore. Kafshët e rralla ne vendin tone si: Ujku, Derri egër, kaprolli, Dhelpra, (Jazbak), dreri, dhia e egër, Macja e egër, Lepuri, Ketri, Thëllëza, shqiponja, Petriti, pata e egër, Lejleku etj, janë rrezikuar te pakësohen si pasoj e dëmtimit dhe ndryshimeve të habitateve te tyre, gjuetisë se pakontrolluar, varfërimit dhe degradimit te ekosistemeve, erozionit dhe shpyllëzimit. Për llojet shtazore është shqetësuese sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës se riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjate fazës se lulëzimit, dhe nxjerrja me rrënjë.

[2] Arian Mavriqi, 2024, Fotograf i njohur në Komunën e Kamenicës e gjetiu

## Zonat e Mbrojtura

Bazuar në të gjitha informatat të cilat janë marrë nga kjo fushë me theks të veçantë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës dhe grupi punues për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis, Kjo fushë (trashëgimin natyrore) analizuar në fazë e analizës së gjendjes dhe parashikohet që: Zonat me vlera të veçanta natyrore për komunën (Planica, Kika, Velegllava, Tugjeci) të shpallën të mbrojtura, të ruhen, mbrohen dhe konservohen dhe zhvillohen me projekte kryesore sipas normave për këto zona. Parashikohet që trungjet e vjetra dhe monumente gjeomorfologjike të shpallën të mbrojtura, të ruhen sensibilizohen, mbrohen dhe konservohen.

## Rreziqet Natyrore

Vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit, te shtazët dhe te bimët dhe fatkeqësi të tjera, që i shkakton natyra. Fatkeqësitë e tjera nënkupton fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, zjarret, fatkeqësitë në xeherore, shkatërrimi i digave dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike dhe industriale, që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje, gjendja e jashtëzakonshme, emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik I sistemeve energjike te furnizimit me rryme, telekomunikacioni dhe teknologjisë informative, aktet terroriste dhe mënyrat e tjera të rrezikimit masiv. Territori i komunës së Kamenicës vazhdimisht është ballafaquar dhe mundë ballafaqohet me fatkeqësi natyrore dhe të tjera, kështu që Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka përgjegjësi për menaxhimin e këtyre situatave emergjente, siç që janë: - - - - Zjarret Vërshimet Tërmetet Fatkeqësitë e tjera elementare Njëra ndër fatkeqësitë natyrore më sfiduese është Tërmeti, dihet se në pikëpamje sizmologjike, Komuna e Kamenicës si edhe pjesa ma e madhe e Kosovës paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete autoktone shumë të fortë, të cilët i kanë vatrat të cekëta. Territori i Kamenicës ndodhet në zonën e VII dhe VIII merkal, karakteristik e zonës është se ndodhet në mes të vendeve me burimeve Sizmike ose zona sizmogjene (siç quhen ndryshe), si vijon: Zona sizmogjene Kamenicë – Novobërdë – Gjilan me magnitude maksimale M=6.0 shkalla Riter, në krahasim me Kosovën që e karakterizojnë edhe zona sizmogjene Prizren – Pejë si dhe Zona sizmogjene Kopaonik. Këto zona të burimeve sizmike kanë gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojnë edhe në të ardhmen tërmete të fortë. Sizmiciteti i lartë dhe tërmeti i 24 prillit 2002, që preku Rajonin Gjilan, mirëpo vlen të evidentohen edhe tërmetet e kohë pas kohshme të cilat ndodhin në vazhdimësi sikur edhe ato të datës: 06.03.2008 ku sipas Institutit Sizmik të Kosovës ishin tre tërmete edhe pse me shkallë të vogël të intensitetit prej 3.6, 3.4 dhe 3.7 shkallë të Rihterit. (Harta. Zonat e Rrezikuara).

## Thatësira

Thatësia mundë të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla.

## Vërshimet

Përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen. Uji i cili grumbullohet nga reshjet ose shkrirja e bores patjetër duhet ta gjejë një rrugë të lëvizjes së tij. Në këtë rast është e rëndësishme që atij t'i krijohen kushte për një shkarkim sa më të lirë pa pengesa. Komuna e Kamenicës ka një rrjet lumenjsh, por më të rëndësishmit janë: Lumi Krivareka, lumi i Hogoshtit dhe lumi i Desivojcës . Të gjithë këta lumenj derdhen në lumin Morava. Në këtë komunë ekziston dhe liqeni në fshatin Ruboc. Lumenjtë e Kamenicës rrjedhje më të mëdha kanë gjatë muajit shkurt ,mars dhe maj, kurse rrjedha më të vogla gjatë muajit gusht dhe shtatorë. Komuna e Kamenicës është e pasur me burime ujore. Në bazë te të dhënave të Bazës së Hidroekonomies së Kosovës në territorin e Kamenicës janë të rrezikuara rreth 1100 Ha. Në territorin e komunës së Kamenicës ujërat sipërfaqësor përfshijnë një sipërfaqe prej 1021 ha ose 1.97% e sip. të përgjithshme e komunës.

Foto në lumin Krivareka Bimët e vetrritura në shtratin e lumit

Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e saj të lumit Krivareka Hajnovcë-DomarovcRregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e saj të lumit Hogoshtë Hogosht-Domarovc Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e saj të lumit karaqevë Karaqevë-Katunisht Rregullimi i shtratit të lumit dhe pastrimin e saj të lumit Rubovc

Lumi Krivareka deri në derdhjen e tij në lumin Morava, kryesisht kalon pjesë të banuara dhe pranë tokës bujqësore, Meqenëse ka gjatësi të madhe, gjatë vërshimeve shpeshherë shkakton dëme të konsiderueshme. Projekti „Rregullimi i shtratit të lumit "ka arsyeshmëri të plotë si në aspektin ekonomik po ashtu edhe në aspektin e sigurisë së popullsisë nga vërshimet.

Realizimi i këtij projekti do të parandalonte përmbytjen e tokave bujqësore dhe do të mbrontevendbanimet, rrugët nga vërshimet. Gjatë të reshurave të mëdha, lumenjtë Krivareka dhe lumi i Hogoshtit rregullisht dalin nga shtrati duke shkaktuar dëme të mëdha materiale.

Rregullimi i shtratit të lumit krijon mundësi të mira edhe për shfrytëzimin e tokës përgjatë tij për nevoja të bujqësisë. Lumi Morava i cili kalon nëpër territorin e komunës së Kamenicës ka rrjedhje mesatare rreth 6.1m³/s.Gjatë stinëve me të reshura shkakton dëme të mëdha duke dalura nga shtrati dhe vërshuar një numër të madh të tokave bujqësore. Dëmtimi i argjinaturave nga faktori natyror dhe antropogjen ndikon ne rritjen e shkallës së rrezikshmërisë së vërshimeve sidomos në fshatrat Petroc, Ranillug, Koromjan i epërm Koromjan i poshtëm si dhe ne Crep dhe tek Dheu iBardh. Faktorët që ndikojnë në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet janë:

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve),
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve,
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë-rritura pranë brigjeve të lumenjve etj
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.

*Shkalla e erozionit*

Erozioni rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon negativisht në tokat bujqësore dhe në vendbanime.

Rreth 6000km² ose 56% e territorit të Kosovës është i rrezikuar nga kjo dukuri natyrore të shkallës sëI, II dhe III (I - erozion shumë i fortë, II - erozion i fortë dhe III - erozion i mesëm). Edhe në territorine komunës së Kamenicës është prezent faktori natyror erozioni që për pasojë ka humbjen e tokësbujqësore dhe dëmet në ekonomitë familjare. Nga një shkallë e lartë e rrezikshmërisë erozive janë tëpërfshirë 25050 ha ose 48% e sipërfaqes së komunës që i takojnë shkalles me erozion te fortë dheshumë të fortë. Shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri. Nga shkalla më e lartë e rrezikshmërisë që e ka kategoria e erozionit shumë të forte janë të përfshirë11550ha tokë. Harta nr. 2. Shfrytëzimi i tokës.




## Kushtet Socio-Ekonomike

### Ndarja administrative

Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës. Kufizohet në Jug-Perëndim me komunën e Ranillugut, në Perëndim me komunën Novobërdës si dhe në Veri-Perëndim me Prishtinën. Në Verime Komunën e Medvegjës dhe Leskovcit, në Lindje me Vranjën dhe në Lindje dhe Jug-Lindje me Bujanocin. Sipërfaqja e K. Kamenicës është **417** km2, numri i banorëve është **36204** Rezident dhe **4020** Jorezident, gjithsej banor në Komunën e Kamenicës janë **40224,** pozita e mire gjeografike mund të konsiderohet si një mundësi për lidhje te mira rajonale dhe ndërshtetërore.

### Popullsia

Bazuar në rrjedhën e zhvillimit të komponentëve të zhvillimit demografik më realisht mund të planifikohen kërkesat edhe për të tashmen edhe për të ardhmen. Të dhënat për numrin e popullsisë kryesisht i japin regjistrimet e popullsisë. Për periudhën kohore 1948 – 1981i janë të dhënat, për numrin e popullsisë të Komunës së Kamenicës sipas regjistrimeve të popullsisë. Gjithashtu janë shfrytëzuar të dhënat e regjistrimit 1991 që na japin edhe një

vlerësim për faktin se në atë kohë kishte manipulime, por megjithatë **konsiderohen si relativisht të sakta. Të dhëna mjaftë të rëndësishme për popullsinë e komunës konsiderohen** ato të vitit 2004, kur komuna e Kamenicës kishte bërë një regjistrim për nevojat e brendshme komunale. Janë shfrytëzuar edhe të dhëna nga institucione të tjera dhe hulumtimet që janë realizuar në fushën e zhvillimit demografik në Kosovë dhe komunë. Mbi 34 % të popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç. Ndërsa, grup- moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje të vogël, rreth 5% të popullsisë së përgjithshme.

### Tabela 1. Regjistrimet e popullsisë nëpër vite

| **Viti Regjistrimit** | 1953 | 1961 | 1971 | 1981 | 1991 | 2011 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr. i banorëve** | 32305 | 34064 | 37474 | 38934 | 40884 | 40224 |

**Shfrytëzimi i tokës**

Nga e gjithë sipërfaqja e cekur më lart sipërfaqe bujqësore janë 39199.830 ha. (Ara 12284ha, Kullosa 7365.3691 ha). 54.4 % dhe pyje 16510.1305 ha ose 39.6% , (pjesa tjetër është tokë e papunuar 6%).

### Tabela 2. Shfrytëzimi i tokës

| | |
|---|---|
| Kullosa | **7365.3691**ha |
| Livadhet | **2842.3312**ha |
| Pemë dhe perime | 197 ha |
| Vreshta | 1.0 ha |
| Male | **16510.1305**ha |
| **Totali** | **39199.8308ha** |




Figura 6. Shfrytëzimi i tokës

## Trashëgimia kulturore

Komuna e Kamenicës është një vend i pasur me monumente kulturore-historike të lashtësisë.

Monumentet e lashtësisë: Kalatë, Qytetet, Varrezat, Xhamit, Kishat etj., që gjenden në Kamenicë, sipas disa studimeve dhe materialit arkeologjik që është gjetur në to i përkasin dy periudhave të historisë së vjetër:

1.Periudha Ilire

2.Periudha gjatë sundimit Romak deri ne shek.V. Në bazë të vend ngjarjeve vërehet se territori i Kamenicës është i pasur me trashëgimi të kaluarës historike të cilat dëshmojnë kulturën e popullittonë. Një numër i madh i tyre dihet vend ndodhja, ndërsa një numër i madh i tyre mbetet për ti hulumtuar. Këto monumente janë të tipit të Kalave, Fortifikatave dhe Gjyteteve. Gjendja e tyremomentale është shumë e keqe, gjatë periudhës së më vonshme është bërë shkatërrim sistematik ityre, sepse ato sit ë tilla nuk kanë hyrë në mbrojtje deri tash, andaj disa mure gati janë shkatërruar ngafshatarët dhe janë përdorur për ndërtimin e shtëpive private.



*Figura 7. Monument kulturor*

# Bujqësia

Ekonomia ne Komunën e Kamenicës është ne gjendje mjaft te vështirë. Shumica e ndërmarrjeve janë tregtare, pak prodhuese, te cilat punojnë me kapacitete te vogla. Këto ndërmarrje nuk kanë mund mi rrit kapacitetet prodhuese dhe numrin e punëtoreve. Procesi I privatizimit nuk ka dhënë rezultate te pritura. Mungesa e mjeteve financiare ,kushtet e pavolitshme te kreditimit, politika fiskale joadekuate,stimulimi jo i mjaftueshëm në bujqësi janë problem për bujqësi e gjithashtu direkt ne ekonomi. Industria është ne nivel te ulet, dhe të ardhurat nga kjo sferë janë të ulëta. Punësimi është një prej sfidave për autoritetet vendore si dhe nuk shihet ndonjë përpjekje për hapjen e kapaciteteve te cilat do të punësonin një numër me te madh te punëtorëve e veçanërisht të rinjve dhe grave si kategori më te prekura. Migrimi drejt qytetit apo de popullimi i zonave rurale, ne mënyrë direkte po ndikojnë ne zvogëlimin e numrit te fermave. Një nder problemet është edhe se te rinjtë nuk duan te mirën me bujqësi. Të rinjtë ma tepër janë te orientuar te migrojnë jashtë vendit, kurse te vjetrit nuk munden mepunuar në bujqësi ne mënyrën e duhur. Komuna e Kamenicës ka resurse për zhvillimin e pemëtarisëperimtarisë, blegtorisë, bletarisë, për prodhimin e mishit, shpeztarisë si dhe duhet te kemi parasyshresurset pyjore të cilat mundësojnë kultivimin e frutave të malit dhe bimëve mjekuese te cilat mund teluajnë një rrol të konsiderueshëm ne zhvillimin e bujqësisë. Me që një sipërfaqe e konsiderueshmejanë pyje, kjo na mundëson zhvillimin e florës dhe faunës. Pozita gjeografike e komunës na jepmundësi te komunikimit te njerëzve te mallit dhe kapitalit me disa komuna te zonës kufitare siMedvegja, Bujanoci etj. Gjuetia është mjaft e zhvilluar. Prodhimi i mjaltit dhe produkteve tjera temjaltit mund te jap rezultate te mira pasi qe kemi njohës të mirë të kësaj veprimtarie si dhe kushtetklimatike dhe laramania bimore krijojnë kushte te mjaftueshme për kultivimin e bletëve. Mund temendohen edhe mënyra për kultivimin e peshkut, pasi lumenjtë e përshkon komunën ne dy anët e saj. Qyteti ka pas një rritje dhe ekspansion viteve te tetëdhjeta kur kanë funksionuar kapacitetet prodhuesepor edhe kjo ka stagnuar sepse destinim i lëvizjes së popullatës është Prishtina dhe Gjilani. Ne qytetproblem është mosfunksionimi i kapaciteteve prodhuese, dëmtim i tokës bujqësore, mungesa edeponisë për mbeturina dhe mungesa e ngrohjes qendrore. Megjithatë rreth 60% e popullatës jeton ne zona rurale dhe merret me bujqësi. Mekanizmi bujqësor është i vjetruar, parcelat punuese janë te vogla, mungojnë kooperativat dhe profilizimi i buqëve, gjë qe tregon për nivelin jo te mire te bujqësisë. Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 417 km² tokë, prej së cilës 39199.8308 ha është tokë bujqësore dhe male.

**Tabela 3. Toka bujqësore**

| | |
|---|---|
| Tokë e punueshme – Ara | 12284 ha |
| Kullosa | 7365.3691ha |
| Livadhet | 2842.3312ha |
| Pemë dhe perime | 197 ha |
| Vreshta | 1.0 ha |
| Male | 16510.1305ha |
| **Totali** | **39199.8308ha** |

## Industria

Në komunë gjatë viteve 1970-90 shënohet një zhvillim i theksuar industrisë dhe tregtisë. Industria në komunë është bazuar në eksploatim dhe përpunim të pasurive ekzistuese minerale. Mbështetur në këto resurse në të kaluarën në komunë janë ngritur kapacitetet prodhuese të tyre, me ç „rast është punësuar edhe një numër i konsideruar i punëtorëve.

Ndërmarrjet industriale në të cilat është mbështet ky zhvillim, ishin kryesisht të sektorit shoqëror.Investimi në zhvillimin e industrisë përpunuese të mineraleve (jo-metaleve dhe metaleve), tëmaterialit ndërtimor dhe ndërtimtarisë, konsiderohen të jenë mbështetje e mirë për zhvillim ekonomikdhe punësim në komunë. Nevojat për investime në këtë drejtim janë të larta dhe për momentin të parealizueshme. Por në periudhën strategjike në vazhdim, besohet që komuna në partneritet mesektorin privat dhe investitorët eventual të fillon me investime në këtë drejtim.

**Pasuritë natyrore:** Kaolini, magneziti, andeziti, bentoniti, kuarci, hekuri, tufi, rëra, etj, janë disa nga mineralet me të cilat është e pasur Komuna e Kamenicës. Sipas ekspertëve të kësaj lëmie, rezervat ekzistuese të këtyre mineraleve garantojnë eksploatim të gjatë të tyre. Për qëllime të eksploatimit të njëjtave, në komunë janë të vetëdijshëm se nevojiten investime kapitale, të cilat komuna për momentin nuk i ka , por kjo strategji do të realizohet me sektorin privat rastin, njiherit duke krijuar kushte të volitshme për investitor të huaj dhe të vendit.

**Tabela 4. Resurset minerale në komunën e Kamenicës**

| | |
|---|---|
| 1. Magneziti 1.3m/il/t | 8. Tufi 665.000t |
| 2. Andeziti 635.000 m3 | 9. Deltina 30.000 m3 |
| 3. Kaolina 3.5 mil/t | 10. Gelqerori 250.000 m3 |
| 4. Bentoniti 1.2mil/t | 11. Graniti 1.800 t. |
| 5. Kuarci 2.5mil/t | 12. Feldspati 50.000 t. |
| 6. Rëra 200.000 m3 | 13. Zhavori 60.000 t. |
| 7. Hekur 50.000 t | |

## Turizmi

Në Komunën e Kamenicës, për momentin nuk ka objekte si dhe infrastrukturë të nevojshme për ta zhvilluar turizmin. Në sektorin privat pas përfundimit të luftës janë rregulluar gjithsej 2. pishina të cilat veprojnë gjatë stinës së verës, mirë po edhe ato në mungesë të experiences dhe këshillave profesionale nuk janë në nivelin e duhur dhe nuk i kanë të respektuara normat për zhvillimin e këtyre aktiviteteve në përmasa më të gjëra të turizmit. Në këtë kontekst paraqitet nevoja e ndërtimit të një kompleksi të gjerë Hoteliere- Spitalore duke u bazuar në kapacitete komunale si në Gmicë dhe Kikë me një pozitëgjeografike të mirë, për terrene rehabilituese dhe sportive, që do të ndikoj në ngritjen e nivelit të zhvillimit te turizmit. Këto hapësira ka mundësi të shfrytëzohen gjatë stinës së verës dhe dimrit për zhvillimin e sporteve në ecje, kampingje malore si dhe forma të ndryshme të rehabilitimit. Komunën e Kamenicës për aktivitetet dhe investimet për zhvillimin e turizmit gjatë stinës së dimrit potencial relevantë është edhe fshatrat për rreth majës së Kikës, Gmicës, Kranidellit me rrethina ku japin mundësi të arsyeshme për investime në objekte hoteliere për Qendër të skijimit dhe turizëm Verorë në ato vise malore. Të gjitha këto pjesë malore në Komunën e Kamenicës mundësojnë zhvillimin dhe kultivimin e kulturës së gjahut me kafshë të egra të cilat I përshtatën jetës në vise malore, për momentin kemi prezencën e tyre mire por forma e zhvillimit të aktivitetit të gjahut në Komunën tone është e egër dhe e paligjshme dhe ka shkaktuar destabilizim total të këtij sporti në Komunën tone. Zhvillimin e kulturës së gjuetisë në Komunën tone kemi mundësi ta zhvillojmë në pjesët e kodrinore, malore gjeografike të reliefit të Komunës sonë ku mundësit janë shumë të arsyeshme në sipërfaqen kodrinore, malore sidomos ndërmjet Desivojcë, Kolloleq, Kranidell, Tugjec etj. Në komunën ton mundet të zhvillohet edhe kultura e peshkimit rekreativ pasi që në lumenjtë e Komunës sonë ka lloje të mjaftueshme të peshkut. Mirëpo në këtë drejtim mungojnë aktivitetet në kultivimin e llojeve të ndryshme të peshkut. Të luftohen dukurit të cilat dëmtojnë ambientin dhe ndotin lumenjtë që pa mundësojnë zhvillimin e peshkatarisë dhe kultivimin e peshkut. Ndërtimet në formë të egër, kanalizimet e patrajtuara derdhja e ujerave të zeza në lumenj, shfrytëzimi jo adekuat i zhavorrit, është veprim alarmant ku duhet të ndërmerren masa të menjëhershme që të ndërpriten këto dukuri negative me qëllim që ti shpëtojmë lumenjtë natyralë, gjallesat në ujera dhe të ngritim kulturën e turizmit edhe nëpeshkim, ku mundësi për ndërtimin e baseneve për kultivimin e peshkut ka në vendet e rrafshëta sidomos rreth lumenjve si në; Hogosht, Shipashnicës, Kriva Reka (lumi i Lakuar). Në Komunën e Kamenicës ekziston qendra sportive e mbyllur e pa përfunduar që në të ardhmen mundë të shfrytëzohet gjatë stinës së Dimrit, prandaj është më së e domosdoshme që objekti i tillë të kompletohet me gjithë infrastrukturën përcjellëse ngritët ku ai kompleks sportive do ti kishte plotësuar nevojat e qytetarëve të Komunës së Kamenicës për zhvillimin e rekreativitetit sportive gjatë dimrit por njëherë të jetë qendër e pajisur edhe me fusha të ndryshme të sportit në terrene të hapur.

## Transporti

Komuna e Kamenicës në bazë shtrirjes së territorit me territoret tjera ka këto distanca në vijën tokësore , me Komunën e Gjilanit rreth 30 km, me Novobërdën nëse kalojnë rrugës për Gjilan ka një gjatësi prej afro 50 km, ndërsa nëse kalojmë neper rrugën qe përshkon shumë fshatra te Komunës se Kamenicës, si fshatrat Busavatë etj. është afro 25 km më shkurt me Komunën e Prishtinës ne rruge gjatësore që kalon përmes Gjilanit është afro 75 km, ndërsa ajo që kalon kah Artana është rreth 50 km, çka do te thotë se në të dy drejtimet rruga shkurtohet për rreth 50 km. Distanca e qendrës së komunës me qendrat tjera të territorit të Serbisë, me Komunën e Bujanocit rreth 25 km. Me komunën e Medvegjes rreth 35 km por qe infrastruktura rrugore është mjaftë e dobët. Distanca e qendrës së komunës me rrugët magjistrale, kështu komuna jonë gjendet rreth 10 km larg magjistrales Bujanoc- Gjilan, rreth 30 km larg auto udhës ndërkombëtare E75 Shkup-Bujanoc-Vranjë-Beograd. Transporti paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm për qytetarët, institucionet dhe bizneset Kamenicës. Është faktor përmbajtjesor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor por edhe pasojë e këtyre zhvillimeve, luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore midis hapësirave dhe destinimevetë tyre. Transporti në Kamenicë, kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike.

Dukuria e ndërtimeve ilegale në brezin rrugor është alarmuese dhe kërkon intervenim të shpejtë institucioneve kompetente.Sa më vonë qe të intervenohet dëmet do të jenë më të mëdha dhe më vështirë do të jetë të sanohen. Në mungesë të transportit përmes hekurudhës, sidomos të mallrave me tonelata të lartë, rrugëtautomobilistike ngarkohen së tepërmi dhe kështu vie deri te dëmtimi i tyre. Infrastruktura në komunën e Kamenicës marrë në përgjithësi është e një niveli jo të kënaqshëm. Duke shikuar shtrirjen e terrenit, viset malore dhe shtrirjen e popullatës atëherë kemi vështirësi të mëdha në transportimin e njerëzve, prodhimeve të ndryshme, etj.

*TRANSPORTI AUTOMOBILISTIK*

Rrugët lidhëse me fshatrat për rreth janë në gjendje mjaftë të vështirë e sidomos me malësinë e Komunës që ka një numër të madh të popullatës që transportimi i tyre është mjaftë i vështirësuar. Pikërisht për shkaqe të infrastrukturës rrugore është bërë edhe zhvendosja e shumë fshatrave në malësinë e Komunës.Komuna e Kamenicës ka një numër të madh të shërbimeve transportuese në krahasim me gjendjen e infrastrukturës dhe numrit të popullatës. Kështu komuna jonë ka tetë (8) kompani private transportuese, rreth 150 auto taksi duke mos përfshirë kombi busët. Po ashtu ka rreth 4500 automjete personale të regjistruara në tërë Komunën. Komuna e Dardanës ka një rrjet të rrugëve në gjatësi prej rreth 300 km. Edha atë:

Rrugë magjistrale - 2 km

Rrugë regjionale - 100 km

Rrugë lokale - rreth 229 km

Rrugët magjistrale janë të asfaltuara - 85km por në një gjendje jo të mirë, ndërsa të pa asfaltuara janë rreth 15 km.

Rrugë lokale janë të asfaltuara rreth 159 km ndërsa të pa asfaltuara rreth 70 km. Analiza e sinjalizimit horizontale dhe vertikale.Shikuar në tërësi sinjalizimi horizontal është shumë e mangët për të mos thënë nuk ekziston fare. Rëndësia e sinjalizimit horizontale është e rëndësisë së veçantë, duke marrë parasysh domethënien e tyre, prandaj vendosja e tyre duhet jetë në masë më të madhe.

Në komunën e Dardanës, në rrugët regjionale ekziston vija ndarëse e mesit ndërsa në qytet gjendja është e mirë . Prania e këtyre sinjaleve nëpër qendrën e qytetit mund të themi se është e kënaqshme, ndërsa nëpër fshatra ka mungesë të vogël të shenjave. Transporti paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm për qytetarët, institucionet dhe bizneset e Kamenicës. Është faktor përmbajtjesor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor por edhe pasojë e këtyre zhvillimeve, luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore midis hapësirave dhe destinimeve të tyre. Transporti në Viti, kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike.

## Infrastruktura e energjisë elektrike

Në komunën e Kamenicës, elektrifikimi i fshatrave daton që nga viti 1955,ku në këtë vit, elektrifikohen fshatrat Ropotovë e Madhe dhe Panqellë. Në vitin 1957 janë elektrifikuar fshatrat:
Topanicë, Tomancë, Korminjani i Epërmë dhe qyteti i Kamenicës. Në vitin 1958 janë elektrifikuar fshatrat: Ropotova e Madhe, Berivojca, Domoroci, Korminjani i ultë, Koretini, Ruboci dhe Moqari. Në vitin 1959 Ranillugu, në vitin 1961 Gllogovci. Pjesa më e madhe e fshatrave të komunës së Kamenicës elektrifikohet nga vitet 1965 deri në vitin 1975 për të përfunduar elektrifikiminë vitin 1984 ku edhe janë elektrifikuar fshatrat e fundit të malësisë së Kamenicës.
Gjatë kësaj kohe, furnizimi me energji elektrike është bërë nga Bujanoci përmes një linje 35kV,deri te T.S 35/10kV në Ropotovë të madhe. Më pastaj me ndërtimin e T.S 35/10kV në Berivojcë, furnizimi me energji elektrike është bërë nga T.S 110/35kV në Gjilan përmes dy linjave 35kV paralele. Kjo ka ndodhur kështu deri në vitin 2003 kur në Berivojcë është ngritur T.S 110/10(20)kV i fuqisë31.5MVA.
Sa i përket gjendjes së SEE në Kamenicë nga vetë fakti se ende ekzistojnë ato linja dhe ato rrjeta të montuara që nga viti 1955 deri në vitin 1984 tregon se gjendja e rrjetit e veçanërisht e rrjetit të tensionit të ultë(0.4kV) është kritike.
Ndërsa linjat 10kV dhe 110kvV janë në gjendje pak më të mirë.

D.m.th në territorin e komunës së Kamenicës ekzistojnë tri nivele të tensionit(linjave ) me të cilatbartet energjia elektrike edhe ate:
1.Rjeta e tensionit të ultë (0.4kV) me një gjatësi prej 322km2.Linjave 10(20)kV me gjatësi prej afër 209km,dhe 3.Linjës 110kV me gjatësi afër 30km.
Ekziston një T.S 110/10(20)kV me fuqi 31.5MVA

Furnizimi bëhet nga Gjilani përmes linjës 110kV dhe nga Bujanoci(Ristovci), gjithashtu përmes linjës110kV.
Kostoja e kësaj rrjete, e këtyre linjave(10 dhe 110)kV si dhe e këtij T.S 110/10 (20) kV me të gjitha T.S 10(20)/0.4kv vlerësohet të jetë afër 50 milion euro.




Figura 8. Shpërndarja e rrjetit energjetik në Kosovë

## Infrastruktura e ujësjellësit

Procesi i prodhimit, trajtimit dhe distribuimit të ujit të pijshëm ne qytetin e Kamenicës dhe Berivojces si dhe një pjesë e Rubocit, realizohet në dy (2) stacione pompimi në lokacione të ndara mesveti por të integruara në sistemin e shpërndarjes së ujit të pijshëm. Sasia më e madhe e ujit në këtë stacion vjen nga sistemi i drenazhimit i vendosur nën shtratin e Lumit ”KRIVA REKA”, i cili bënë furnizimin e pesë (5) puseve të hapura dhe tri (3) puseve të shpuara nga të cilët përmes pompave horizontale dhe zhytëse mbushet rezervari me kapacitet prej 142 $m^3$ dhe pastaj me anë të pompave tjerabëhet distribuimi në rrjetin kryesor të ujit. Tani është në përfundim e sipër projekti për furnizim me ujëtë pijshëm një pjesë të Lagjes “MALËSIA” në Kamenicë nga një rezervar me kapacitet prej 300 $m^3$. Uji i pijshëm në këtë stacion vjen nga dy puse të shpuara në thellësi prej 54 m, të cilët e mbushin një pus të hapur dhe nga këtu përmes pompave horizontale bëhet distribuimi i ujit në rrjetin kryesor të qytetit.

Pjesa më e madhe e banorëve të Komunës së Kamenicës që jetojnë në zonat rurale, furnizohetme ujë të pijshëm nga burime të ndryshme individuale (puse të hapura,kroje malore, lumenj etj),i cili nuk trajtohet profesionalisht dhe nuk është i verifikuar nga institucionet zyrtare.

Momentalisht në funksion janë këta ujësjellës në: Topanicë, Karaçevë e Poshtme dhe Reqankurse në ndërtim e sipër janë në: Shipashnicë e Epërme, Kopernicë, Kolloleq dhe Koretin. Komuna e Kamenicës është e pasur me rezerva hidrike falë 3 (tri) lumenjve:

(Lumi i Krivarekes, Lumi i Hogoshtit dhe Lumi i Desivojcës) si dhe Lumenjve tjerë më të vogël, dhe përrojve të cilët kanë konfiguracion të përshtatshëm, kualitet të mirë, dhe sasi të mjaftueshme për shfrytëzimin e ujit të pijshëm.

## Infrastruktura e Ujërave të Zeza

Territori i komunës së Kamenicës ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi. Në komunë janë tre lumenj Krivareka me degët e saja lumë burimor, lumi i Hogoshtit dhe lumi I Desivojces. Lumi Krivareka buron në malet e Gollakut dhe deri në hyrje te fshatit Hajnovc itakon lumenjve me ndotje të kategorisë së parë(lum i pastër). Prej fshatit hajnovc e deri ne hyrjete Kamenicës i takon shkallës së dytë (ndotje e lehtë). Pas daljes nga vendbanimi i Kamenicës e deri ne bashkim me lumin Morava i takon shkallës së dytë shndërrohet në lum me ndotje të kategorisë dytë (ndotje e lartë). Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale pa asnjë trajtim paraprak lëshohen në Lumin Krivareka dhe rritë shkallën e ndotjes së lumit. Lumi Hogoshtë është i pastër deri ne hyrje te vendbanimeve (ujëra burimore) pas shkarkimit te ujërave të zeza dhe hedhjeve të mbeturinave në shtretërit e lumenjve kalon ne shkallen e ndotjes dytë. Lumi I Desivojces deri ne vendbanimin e Shipashnices se epërme I takonshkalles së parë të pastërtisë, nga aty e deri ne Morav i takon shkalles me te lart te ndotjes. Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumenj .

Çdo banor shkarkon 16.46m³ ujëra të zeza. Vetëm Kamenica si qytezë me 7363 banorë shkarkon 6.5 l/s ose 47859,5 m³/vit ujëra të zeza të pa trajtuara në lum brenda vitit pa llogaritur këtu objektet shoqërore, industriale etj. Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, lumenjtë ndoten dhe degradohen edhe nga mbeturinat që i hedhë popullata lokale, nxjerrja ilegale e rërës, shkatërrimi i florës pranë brigjeve të lumenjve, shpëlarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike, nga objektet industriale etj. Rekomandohet për Komunën e Kamenicës të përcaktohet për variantën e parë dhe komuna të ndaj sipërfaqe tokësore për ndërtim impianti në mes fshatit Kormjan dhe Dheut të Bardhë. Arsye është për shkak të konfiguracionit të terrenit.

Infrastruktura e varrezave

Nga informatat të cilat janë marrë nga bashkësitë fetare në Kamenicë, dhe analiza e bërë në këtë fushë, çdo vendbanim në K. Kamenicës ka lokacione te caktuara te varrezave, në disa vendbanime ka dy e më tepër lokacione të varrezave. Në bazë të analizave në teren, grupi hulumtues i përfaqësuar edhe nga përfaqësuesit e bashkësive fetare kanë identifikuar lokacionet e varrezave në tërë territorin e Komunës së Kamenicës dhe është konstatuar se një pjesë e tyre i plotëson kërkesat edhe për 10 vitet e ardhshme, duhet masa për plotësim me infrastrukturë, mirëmbajtje dhe menaxhim. Janë planifikuar edhe hapësira të reja për varreza të cilat janë prezantuar në hartën e infrastrukturës së varrezave. Gjatë marrjes së informatave është vërejt se gati shumica e varrezave nëpër vendbanime janë në gjendje të keqe dhe në gjitha varrezat shqiptare (myslimane), shqiptare (katolike) dhe serbe (ortodokse) ju mungon infrastruktura dhe elementet përcjellëse të varrezave. Në varrezat e qytetit të Kamenicës mungon infrastruktura e nevojshme për varrim dhe qëndrim, organizimi i hapësirës dhe rregullimi i varrezave, gjelbërim dhe aktivitetet tjera të nevojshme. Situatë e njëjtë është edhe në gjitha vendbanimet e tjera të komunës së Kamenicës.

# SWOT ANALIZA

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundësi për përmirësim.

*Zonat me Probleme Mjedisore*

Ky seksion bën një përmbledhje të analizës së mësipërme të kushteve mjedisore në Kamenicësdhe vë në dukje:

- Zonat që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilave mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, në se nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur ngapërshkrimet e bëra në këtë kapitull.

Diskutim i grupeve të faktorëve në analizën SWOT.

*Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor*

Të gjithë lumenjtë dhe proskat, vuajnë degradim dhe ndotje mjedisore të shkaktuar nga depozitimi i vazhdueshëm i mbetjeve të ujërave të ndotura dhe i lëndëve të ngurta. Pastrimi ilumenjve të Kamenicës kërkon një menaxhim më të mirë të mbetjeve të ngurta, sidomos në vendbanimet e mëdha, si dhe sigurimin e kolektorëve të duhur gjatë rrugës. Në se nuk kontrollohet rritja e numrit të automjeteve dhe nuk ndërmerren masa për tëpërmirësuar rrugët, standardet e karburanteve dhe të shkarkimeve, atëherë rritja e parashikuar me katër herë më shumë e mjeteve do të ketë pasoja në cilësinë e ajrit. Masat e ndërmarra nga Qeveriapër reduktimin e makinave të vjetra nëpërmjet taksimeve dhe rënia e ritmit të ndërtimeve kanë dhënë efekte pozitive në ndotjen e ajrit, por janë të pamjaftueshme për të siguruar cilësi te ajrit dhe nivel te zhurmave brenda standardeve.

Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore

Bazuar në të gjitha informatat të cilat janë marrë nga kjo fushë me theks të veçantë ngaInstituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës dhe grupi punues për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis ,Kjo fushë (trashëgimin natyrore) analizuar në fazë e analizës së gjendjes dhe parashikohet që: Zonat me vleratë veçanta natyrore (Planica, Kika, Velegllava, Tugjeci) të shpallën të mbrojtura, të ruhen, mbrohen dhe konservohen dhe zhvillohen me projekte kryesore sipas normave për këto zona. Parashikohet që trungjet e vjetra dhe monumente gjeomorfologjike të shpallën të mbrojtura, të ruhen sensibilizohen, mbrohen dhe konservohen.

## Peizazhet

Komuna e Kamenicës është e pasur edhe me peizazhe dhe ekipet punuese kanë paraparë trajtim adekuat të laramanisë së peizazheve duke parashikuar masa dhe veprime për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tyre: Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për ta mbrojtur, intervenimet e njeriut në pikat skenike -pika atraktive duhet të minimizohen. Posaçërisht në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit.

- Kika parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për skijim dimëror dhe veror dhe për shëtitje si dhe qendrën mjekësore për rehabilitim.
- Pllanica parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për shëtitje.
- Tugjeci parashikohet që të zhvillohet dhe fuqizohet me elemente të pushimoreve dhe staza për skijim dimëror dhe veror dhe për shëtitje si dhe qendrën mjekësore për rehabilitim.
- Lumi i Desivojcës, Hogoshtit, Kremenatës edhe në këto zona janë planifikuar rrethim i zonës dhe është planifikuar që të mos ket ndërtime të tjera.
- Peizazhet bujqësore parashikohet që këto zona të mbrohen dhe zhvillohen me rrugë që i shërbejnë poashtu janë paraparë staza për ecje, llojllojshmëria e produkteve bujqësore është një parakusht i rëndësishëm për mirëmbajtjen e strukturave të vogla të këtyre peizazhit.
- Livadhet dhe kullosat është paraparë që të mbjelljen e llojeve të shumta të bimëve barishtore.
- Vargmalet është paraparë që të mbrohen nga prerja e pakontrolluar e pyjeve dhe zjarret duke penguar erozionin i cili është fenomen i cili paraqitet në zonat e zhveshura.

## Argumente të Analizës SWOT

***Pikat e forta***

Në komunën e Kamenicës ekzistojnë hulumtime të natyrave dhe fushave të ndryshme të cilat janë bërë edhe në të kaluarën edhe tani ka një inventarizim bukur të mirë të identifikimit të problemeve mjedisore, ka analiza për ekosisteme (nga studentët) ka strategji të zhvillimit ekonomik, analizë hapësinore, plane dhe projekte të zhvillimit komunal dhe mbrojtje të mjedisit si dhe këtë dokument VSM) i cili analizon në mënyrë sistematike ndikimet potenciale mjedisore nga aplikimi i Planit Zhvillimor Komunal. Duke qenë komunë me një bujqësi të zhvilluar sidomos lider për hortikulturë dhe pylltari poashtu mjaft të zhvilluar, kjo komunë është në avantazh për shkak të pozitë së saj që ka si zonë kufitare por edhe vetë si komunë si zona ekonomike dhe sociale me potenciale të konsiderueshme të zhvillimit ekonomik, turistik, komunikimet (rrjeti nacional dhe ndërkombëtare i infrastrukturës). Pika të forta janë edhe prezenca e kapaciteteve të zhvilluara intelektuale, kapacitetet rinore. Kemi edhe për çdo ditë e më shumë instalimin e teknologjive inovative dhe reduktim të dukshëm të industrive ndotëse. Legjislacioni mjedisor është drejt përafrimit me atë të Bashkimit Europian.

***Pikat e dobëta***

Kamenica vazhdon të ballafaqohet me zbrazje të disa vendbanimeve në pjesën verore dhe presion zhvillimi në disa vendbanime, zbrazja e këtyre vendbanimeve dhe ndikimi i presionit të rritjes dhe zhvillimit në disa vendbanime tjera determinohen kryesisht me mungesën e vendeve të punës, papunësisë mungesa e shërbimeve dhe kulturës së jetesës, faktorë që duhen të manaxhohen. Në planin administrues niveli i ulët i aftësive në segmente të administratës lokale ngadalëson kapacitetet manaxheriale. Probleme me pronën private të truallit, privatizimet, prania e hot spoteve mjedisorë si ajo te miniera dhe në pikat tjera, mungesa e zbatimit korrekt të legjislacionit, veçanërisht atij mjedisor, krahas zhvillimeve të pa kontrolluara gjate dy dekadave te fundit, janë pjesë e pikave të dobëta në këtë analizë. Pika të dobëta vazhdojnë të mbeten mangësitë në trajtimin e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, të ndërtuar dhe natyrore, infrastrukturës, veçanërisht në furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimi i ujërave të zeza, mungesa e pastrimit të ujërave të zeza, menaxhimi i dobët i mbetjeve komunale, etj.

***Mundësitë***

Mundësitë e Kamenicës janë të mjaftueshme pasi që është në zonë kufitare, ka zona të mjaftueshme të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike si dhe mbështetjen e mundshme të donatorëve dhe qeverise, është e mundur që komuna të vazhdoj të hartoje dhe zbatoje plane, programe dhe iniciativa të tjera për zhvillimin e studiuar të pjesëve të trajtuar me ketë plan zhvillimor komunal dhe trajtuara si zona për shfrytëzime të ndryshme, trajtimin e hapësirave të zgjeruara ndërtimore tëparapara me planë, hapësirave pyjore, peizazheve atyre rekreative dhe përmirësimin e treguesve mjedisorë. Në Planin e Zhvillimit Komunal është e mundur të rritet ndjeshëm aplikimi i Ligjeve dhe Vendimeve të Kuvendit Komunal në favor të mjedisit dhe shëndoshjes së financave publike komunale. Me qëllim të rritjes së hapësirave publike rekreative është e rekomanduar inkurajimi i biznesit privat në hapësirat rekreative (parqe, salla lojërash, fusha sporti, sipërfaqe për fëmijët). Rritja e cilësisë së

transportit publik është një mundësi që duhet të zhvillohet.

***Kërcënimet***

Mos trajtimi i hot spoteve mjedisore, mos trajtimi i zonave të mbrojtura mundë të shkaktoj kërcënime serioze mjedisore dhe shëndetësorë në komunën e Kamenicës. Humbje e vlerave natyrore, rekreative, shkencore dhe turistike, vendbanime të tëra të mbesin pa asnjë banor, kostoja e shërbimeve të ngritët deri në shkallën që shkakton trazira sociale dhe ekonomike. Problemi i pronësisë së tokës sidomos mungesat e pronave komunale për zhvillime përbejnë një grup problemesh shqetësuese ndikimi i të cilëve do të vazhdojë gjatë. Nëse bazohemi në faktin se blerja e sipërfaqeve për parqe, hapësira shlodhëse kërkon financime të mëdha dhe ne kontekstin e buxhetevejo të mëdha të Kamenicës përbejnë një tjetër kërcënim.

| **Përparësitë** | **Dobësitë** |
| --- | --- |
| Në përgjithësi me PLVM janë trajtuar të gjithaproblemet dhe sfidat mjedisore<br>Në përgjithësi PLVM është një projekt i mirë; Kushte të përshtatshme fiziko-gjeografik, turizëmi zhvilluar dhe burime natyrore kryesisht të mjaftueshme;<br>Interesim në rritje i qytetarëve, autoriteteveshtetërore dhe shoqërisë civile për mjedisin Legjislacion mjedisor dhe planifikimi hapësinor i zhvilluar dhe përmirësuar;<br>Prani e teknologjive inovative në procese industriale dhe ndërtimore;<br>Kushte të mira të transportit të mallrave dhenjerëzve;<br>Rritja e efektshmërisë së zbatimit të Ligjeve dhe detyrimeve financiare te popullsisë dhe biznesit nëraport me taksat komunale;<br>Përfshirja e ekipeve të kualifikuara në zbatimin e planeve dhe hartimin e projekteve të rëndësishme në kuadër të PLVM-së; | Mungesa e disa informatave për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara me PLVM<br>Shkallë e lartë e ndërtimeve informale;Përqindje e lartë e papunësisë;<br>Shpopullimi i zonave malore dhe përqendrim ikonsiderueshëm në zonat e ulëta;<br>Rrugë me përmbajtje jot ë plotë (trotuar,parkingje, etj)<br>Shkallë e konsiderueshme nga ndotja e zhurmës dhe gazrave të djegieve të brendshmemotorike;<br>Motivim i ulët në segment të caktuar tëadministratës publike dhe qeverisjes lokale; Zvogëlimi i hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave të tjera publike;<br>Ndërtimi I banimit kolektiv pa norma tëduhura urbanistike dhe ndërtimore; Mungesa e koordinimit me komunat për rreth; Infrastrukturë jo shume e zhvilluar dhe epaintegruar (jo shumë funksionale); Menaxhim i dobët i mbeturinave;<br>Mos trajtimi i hot spoteve mjedisore;Menaxhim jo i mirë i turizmit;<br>Shkallë e ulët e të hyrave vetanake nëbuxhetin e komunës; |

| Mundësitë | Kërcënimet |
| --- | --- |
| Planifikimi i masave për mbrojtje dhe zhvillim tëmjedisit;<br>Gatishmërie donatorëve dhe Qeverisë për trajtim tëpikave të nxehta mjedisore;<br>Burimet alternative të energjisë së erës.<br>Zhvillimi i kapaciteteve manaxhuese të politikave,planeve dhe programeve në nivel komunal;<br>Krijimi i një Forumi qytetar gjithë përfshirës për kualitet të jetës më të mire, si nje njësi për oponencëdhe edukim mjedisor;<br>Bashkëveprim i kordinuar me komunat tjera; Ndërtimi i impjantit regjional dhe trajtimi i përkohëshëm në pikat e fundit të derdhjeve të ujit tëpërdorur.<br>Përmirësimi i shërbimeve në transportin publik; Përfshirja e biznesit privat në hapsirat pyjore,të gjelbra dhe rekreative (parqe, salla lojrash, sipërfaqe për femijët). | Rrezikim i shëndetit të populates;Prishje e balancit mjedisor;<br>Shkatërrim i resurseve tokësore, ujore dheresurseve tjera;<br>Shkatërrim i ekosistemeve, biodiversitetit,florës dhe faunës;<br>Shkatërrim i tras hëgimisë kulturore dhe natyrore;<br>Konflikte në lidhje me çështjet e pronësisë; Pakësimi i hapësirave publike për shkak tëpresionit;<br>Mungesa dhe/ose kosto e lartë për dispononime sipërfaqeve të lira për projekte zhvillimore;<br>Ulje e ndjeshme e biodiversitetit;<br>Mungesa e koherencës midis aksioneve të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, donacioneve dhe departamenteve universitare/studiove profesioniste etj. |

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS
# KOMUNA E KAMENICES -2024-2028

## Vizioni i Komunës së Kamenicës

Vend i resurseve natyrore me traditë industriale Komuna e Kamenicës do të jetë vend i ofertave të mëdha për investitor të brendshëm dhe të jashtëm. Vend i përshtatshëm për zhvillim të bujqësisë moderne dhe të organizuar. Komunë policentrike me lidhje funksionale, komunale dhe rajonale si dhe me vlera të trashëgimisë kulturore. Vend ku përkrahet dija, puna, mirëqenia, në funksion të kualitetit jetësor dhe mjedisorë.



*Foto 1. Rregullimi i Parkut për banorët e banesave kolektive*





*Foto 2 dhe 3. Rregullimi i shtegut të këmbësorëve – Nga Ura e Qyteti e deri tek Fabrika e Kpurdhave Fungo-FF*



*Foto 4. Foto në Qendër të Qytetit – Gjendja e mëhershme*



*Foto 5. Gjendja e Tanishme e Shtegut të Këmbësorëve dhe çiklistëve*







*Foto 6,7,8 – Tek Komuna e Kamenicës, Mbjellja dhe Dekorimi i Komunes së Kamenicës me florë të re*



*Foto 9.  Rregullimi i Hapësirave për Parkim për Banorët e Banesave Kolektive*



*Foto 10. Rregullimi i Parkut të Lodrave për Fëmijet e banesave kolektive*





*Foto 11,12 – Hapësirë për Personat e Hendikepuar*









*Foto 13,14,15,16 – Objekte të vjetruara të cilat do të rrënohen dhe do të kthehen në hapësira të gjelbra*





*Foto 18,19 – Mbjellja e drunjëve dekorativ, vendosja e shportave për mbeturina*





*Foto 20,21 – Sheshi i Qytetit, rruga Berivojcë-Kamenicë me drunjët dekorativ, shtegu i çiklistëve dhe këmbësorëve*



*Foto 22. Gjendja e mëparshme e shtegut të këmbësorëve*



*Foto 23. Gjendja e tanishme e shtegut të këmbësorëve ana e majtë, ana e djathtë do bëhet në të ardhmen*

# Koncepti i Zhvillimit Hapësinor i Kamenicës

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin Planit Zhvillimor Komunal kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor disa konceptedhe skenarë të mundshme të zhvillimit hapësinorë të vendbanimeve, pas analizës serioze në rrafshin profesional, politike por edhe me shoqërinë civile, duke marrë parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në hapësirën e komunës së Kamenicës por edhe të gjitha implikimet që reflekton kjo gjendje në aspektin ekonomik, social dhe mjedisorë ështëkonstatuar se për të arriturZhvillim dhe mbrojtje e tokës bujqësore Rritje e komunës në mënyrë të qëndrueshme

Zhvillim ekonomik,social dhe mjedisor të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar

Ofrim të shërbimeve dhe mundësive sa ma afër,shpejtë dhe lirë për qytetarët.

Duhet bërë zhvillimi i vendbanimeve me konceptin e zhvillimit hapësinor policentrik me tri segmente lineare segmenti i parë Kamenicë -Rogaqicë, segmenti i dytë Kamenicë - Hogosht si dhe segmenti i tretë Kamenicë - Strezoc që ndryshe do ta quajmë edhe Koncepti i "Diellit" Policentrik.

Për plotësimin e rrjetës urbane të vendbanimeve me funksione dhe përmbajtje dhe për një zhvillimmë të baraspeshuar hapësinor të territorit të komunës së Kamenicës, vlerësohet prioritare zhvillimi i shpejte i qytetit të Kamenicës, Rogaqicë, Hogosht, Strezoc dhe disa nën - qendrave si që janë Koretini, Hodonoci, si dhe Muqiverci, si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomik e mjedisore.

Ky koncept i konsideruar si racionale dhe efikase nga grupet punuese për zhvillim të planifikuarKomunal, si bosht të vetin orientues për arritjen e vizionit të Komunës së Kamenicës konsideron nevojën e zhvillimit (ekonomik,social demografik) e mjedisor) të sinkronizuar, në kohë e hapësirëtë qendrës komunale edhe të nën - qendrave të cilat do të jenë në pozitën e vendbanimit komplementar në kuptimin se funksionet themelore të këtyre vendbanimeve plotësojnë funksionet

e vendbanimeve tjera brenda ndarjes hapësinore policentrike, ashtu që këto të sigurojnë edhe lidhjen funksionale të rregullt dhe të mirë të mbarë hapësirës brenda kësaj komune dhe rajonit.

Specifikat e zhvillimit të vendbanimeve në komunën e Kamenicës, kërkojnë që në të ardhmenkoncepcionit të urbanizimit ti hyhet në mënyrë tepër elastike, Perveç urbanizimit për qendrat kryesore e nën - qendrat, lansohet koncepti edhe për urbanizimin kompakt të fshatrave tjera. Qendra komunale Kamenica duhet te orientohet e ndërtohet me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm,zhvillime të rëndësishme në disa pajisje dhe përmbajtje urbane duhet pritur edhe në Rogaqicë, Hogosht, Strezoc, të cilat do ti përgjigjen funksionit të Kamenicës në hapësirë, komunë, regjion dhe nivel të Kosovës por edhe në Rogaqicë, Hogosht dhe Strezoc brenda këtyre zhvillimeve Shkalla e urbanizimit duhet te rritet në harmoni me trendet globale,tani më tepër se gjysma e popullsisë botërore jeton në vendbanime urbane. Shtimi i shpejte i popullsisë urbane dhe i

vendbanimeve gjysmë - urbane dhe popullsisë gjysmë - urbane mund te pritet në vitit në vijim, si rezultat i investimeve për plotësim të standardeve për para qasje të Kosovës në strukturat Evropiane, zhvillimit ekonomik dhe i ndërtimit të kapaciteteve industriale dhe gjatë kësaj periudhe gjerë në vitin 2021.

Numri i vendbanimeve urbane e gjysmë -urbane të propozuara me ketë plan në të ardhmen do të kompletojnë strukturën urbane . Rolin më të rëndësishëm në ketë drejtim do vazhdoj ta ketë Kamenica,si qendër administrative dhe komunale dhe vendbanimi me i madh Komunalë.

Duhet bërë zhvillimi i vendbanimeve me konceptin e zhvillimit hapësinor policentrik me tri segmentelineare segmenti i parë Kamenicë - Rogaqicë, segmenti i dytë Kamenicë - Hogosht si dhe segmenti i tretë Kamenicë - Strezoc që ndryshe do ta quajmë edhe Koncepti policentrik i “Diellit”. (Harta. Ndarja hapësinore e Kamenicës-Koncepti Policentrik i Diellit)

Ky koncept përmbajtësish është policentrik i kombinuar me elemente lineare me tri segmente, segmenti i parë Kamenicë -Rogaqicë , segmenti i dytë Kamenicë - Hogosht si dhe segmenti i tretë Kamenicë - Strezoc që ndryshe do ta quajmë edhe Koncepti i “Diellit”që ndryshe e kemi quajtur edhe si Koncepti i Diellit ,elementet lineare janë ekzistuese edhe se në të ardhmen nuk do të favorizohen segmente tjera, ky koncept i zhvillimit synon fuqizimin e nën qendrave si dhe monitorimin,funksionalizmin e rehabilitohen për aq sa është e mundur të tri segmenteve me hartimin e planeve rregulluese.

Tendencat e shprehura ne shtimin dhe koncentrimin e popullsisë dhe rrethanat tjera te cilat do të kenë ndikim në proceset e urbanizimit - kushtet natyrore, zhvillimi dhe kompozicioni i infrastrukturës dhe elementet tjera të ekonomisë eksterne në hapësire, do të ndikojnë që këto procese të jenë më të theksuara në zonën rreth rrugës Hogosht - Dheu i bardhë dhe Krilev- Kamenicë, Njëkohësisht, ky do të jete edhe boshti kryesor territorial i zhvillimit në të cilin do të formohet edhe njëra ndër degët e sistemi kryesor urban, por edhe segmenti Krilevë – Kamenicë - Rogaqicë - Hogosht do jetë boshtë i rëndësishëm i zhvillimit edhe se këtu do synohet një lëvizje dhe fuqizim i aksit Kamenicë -Muqivërc -Rogaqicë-Vrajë, Kamenicë-Hogosht-Tërsten- Leskovcë, Kamenicë-Tugjec-Bajë e Siarinës, Kamenicë - Krilevë-rishtinë, Kamenicë-Busavat- Novobërd, Kamenicë- Petroc-Gjilan , Kamenicë-Dheu i Bardhë- Bujanoc, për plotë arsye dhe me ketë do kompletohet edhe boshti tjetër kryesor urban, këto boshte zhvillimi dhe nënqendrat në to duhet të kenë prioritet në planifikimin hapësinor dhe urban dhe zhvillimet në përgjithësi.




Figura 9. Koncepti i zhvillimit te Kamenicës

Plani do të fuqizoje komunën për të luajtur rol me aktiv mes paleve për të nxitur zhvillimin e komunës në bashkepunim me pronarët e trojeve per te ofruar mundesi perfitimi per sherbime publike. Plani gjithashtu rreket te integroje dhe permiresoje situaten aktuale komunal. PLVM-ja parasheh nje zhvillim me miqesor me mjedisin, permes pyllëzimit, zhvillimit të pyjeve,shiritave të gjelbër,tampon zonave të gjelbra,mbrojtjen e zonave dhe peisazheve mjedisore,krijimit të disa parqeve, shtimit te siperfaqeve te gjelbra brenda vendbanimeve, rrjetit te plote te levizjes se bicikletave, etj.

PLVM-ja e Kamenicës është në përputhje me Ligjin e Planifikimit Hapësinor. Ai shoqerohet me relacionin teknik, rregulloret, dhe GIS për të paraqitur modelin e zhvillimit në mënyre sa më saktë dhetë gjeoreferencuar, duke lehtesuar procesin e metejshem të planifikimit të integruar.

Nje grup ekspertesh mjedisi janë përfshire për të lehtësuar procesin e VSM dhe per te pergatitur raportin përkatës. Fillimisht hartimi i VSM e cila ka kaluar përmes rishikimit te dokumenteve ekzistues dhe paraqitjes se nje liste me kritere mjedisore që kufizojne zhvillimin komunal të Kamenicës në zona të ndjeshme mjedisore. VSM po hartohet njekohesisht me Planin zhvillimor Komunal. Si e tille VSM po kryhet kur alternativat janë ende të hapura. Po konsideron efektet mjedisore të propozimeve strategjike dhe paraqet elementet mjedisore të qenësishëm që kufizojnë zhvillimin urban, dhe po ndihmon në marrjen e vendimeve për planifikimin zhvillimor komunal në nivel strategjik.

Pjesemarrja publike është shume e rendesishme per hartimin e PLVM-së. Komuna ngriti Grupe punuese qe siguruan perfshirjen e eksperteve të fushes, si edhe Ekipin komunal të planifikimit që mundesoj vemendjen ndaj gjithe spektrit te shqetesimeve qytetare. Qofte grupet punuese dhe qofte ai komunal i planifikimit jane mbledhur ne disa dhjetera takime per te shprehur komente, verejtje apo sugjerime per hartimin e nje Plani Zhvillimor Komunal sa me perfshires. Pervec ketyre takimeve gjateprocesit te hartimit te Planit, Komuna ofroj mundesinë që publiku i gjere te shqyrtoje Projekt-Planin për pyetje, verejtje, komente ose sugjerime. Vetem pas grumbullimit dhe trajtimit te plote te seciles prej pyetjeve, verejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve te publikut komuna do paraqese variantinperfundimtar te Planit Zhvillimor Komunal për miratim në Kuvendin Komunal duke pas parasyshedhe komentet,vrejtjet dhe sugjerimet e MMPH-së.

Plani i Zhvillimit Komunal i Kamenicës pasi u shoqërua me pjesëmarrje të gjere publike në nivelin teknik dhe strategjik, me vlerësim strategjik mjedisor, me sistem te informacionit gjeografik, planifikim strategjik buxhetor, si dhe mundësinë e publikut te gjere te konsultohet dhe te shprehet për projekt-Planin. Si e tille, kjo alternative është me e mira paraqitur ne PLVM.

Konceptin e zhvillimit hapësinor policentrik me tri segmente lineare apo Koncepti i "Diellit" është analizuar edhe në aspektin e ndikimit strategjik mjedisor dhe është vlersuar se është një koncept i cilika ndikim më së paku në mjedis duke e mbrojtur tokën nga ndërtimet e egra duke ndikuar në kompaktsimin e vendbanimeve, ka për qëllim ofrimin e shërbimeve dhe ruajtjen e balancit demografik, kapërqëllim ruajtjen e biodiversitetit dhe habitateve natyrore etj.

Shkalla që PLVM-ja Ndikon në Planet e Tjera

PLVM-ja vlerësohet të ketë pasur një vështrim të plotë të planeve sidomos të PLVM-së dhe PZHU-së aktuale e cila eshte akoma ne fuqi si dhe planeve të ndryshme të cilat janë zhvilluar në niveltë Kosovës ose Planeve dhe Projekteve të cilat janë bërë më herët në Komunën e Kamenicës. Të gjithakëto planet e më hershme si ato para viteve të 90-ta ashtu edhe planet rregulluese urbanistike per zonen urbane janë marrë në shqyrtim dhe vlerësohet se gjendja në terren ka ndryshuar.

Disa nga aspekte Kryesore të Gjendjes Aktuale Mjedisore

Të dhënat më poshtë i referohen gjëndjes mjedisore të tanishme në komunën e Kamenicës. Qëllimi kryesor i diskutimit të të dhënave bazë është të identifikojë gjëndjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhenefektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të planit zhvillimor komunal të komunës së Kamenicës. Impaktet potenciale të zhvillimit të PLVM-së mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e Planit nëpërmjet indikatorëve të gjendur/të supozuar sasiorë ose cilësorë. Esencialisht, gjëndja mjedisore e komunën e Kamenicës karakterizohet nga përshkrimi i receptorve mjedisore, siç kërkohet nga Direktiva e VSM, të përshkruara më poshtë:

Popullsia dhe Shëndeti publik;

Biodiversiteti, Flora dhe Fauna;

Zonat e mbrojtura të natyrorës;

Cilësia e ajrit dhe zhurma;

Faktorët kilamtikë, ndryshimet klimatike;

Uji në përgjithësi;

Toka bujqësore dhe peisazhi;

Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);

Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkiteturale dhe arkeologjike)

Popullsia dhe Shëndeti publik

Komunën e Kamenicës e përbëjnë 58 vendbanime prej të cilave qyteti është vendbanimi karakterit urban, Kamenica me 7363 banor ose 18.3 %, të popullësisë së përgjithshme.

Vendbanimet tjera janë rurale, me numrin e popullsisë prej rreth 32861 banorë ose 81.7 % të popullsisë, në vitin 2011. Madhësia mesatare e vendbanimeve është 693.517 banorë, në vitin 2011, ndërsa dendësia mesatare e popullsisë arrin në 96.46 banorë në km², por me dallime të mëdha, varësisht nga karakteristikat gjeo-morfologjike të terrenit. (shiko hartën dhe tabelën). Dendësia më e lartë e popullsisë është në fshatin Hodonoc ku mesatarisht jetojnë rreth 596.97 banorë në një km², Rogaqicë me 550.28 banor për km², dhe më pas vjen qyteti i Kamenicës me 475.85 banorë në një km².

Për shkak të kushteve të jetesës vërehet se familjet e reja, përgjithësisht, tentojnë të vendosen në disa vendbanime si Kamenicë, Gjilan, Prishtinë etj., gjë që kërkon përmirësime të rëndesishme infrastrukturore në to, më shumë energji, ujë, rrugë, shkolla, kopështe.

## Shëndeti

Ndikimet në shëndetin e banorëve relevante për VSM, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë (komponente mjedisore të tilla si ajëri, uji apo tokë nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit më njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisorë. Dëndësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja ehapsirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, perkeqesimin e parametrave mjedisorë të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërsisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit. Ne komunën e Kamenicës, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF.

Çeshtje Ekzistuese Mjedisore të Lidhura me Popullsine dhe Shëndetin

Një gamë çështjesh, si më poshtë, janë identifikuar që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

Mbrojtja e mbulesave vegjetative;

Mbrojtja e korridoreve të qarkullimit të shtazve dhe bimëve;

Mbrojtja e zonave të llojeve të bimëve mjekuese;

Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit;

Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet tëlartë;

Tuajtja e burimeve të ujit dhe kaptazheve;

Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;

Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate ngashërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;

Raportet ndërtimore me siperfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;

Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;

Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore tëpellgut;

Ndertimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave te zeza si dhe manaxhimi imbetjeve.

Veçori Natyrore Kryesore të Komunës dhe Zonat që Ndikohen

Në kapitullin e gjendjes ekzistuese është elaboruar mjaftueshëm sa i pëërketë veçorive natyrore të komunës së Kamenicës.

Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe

gjeologjik. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcenuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustrohet në disa nga shifrat që mundë të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani (shih tabelen e shfrytëzimit të tokës). Shumfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërsie pejsazhesh e gjelbrimi.

Zonimi i territorit të komunës së Kamenicës

Bazuar në veçanti si koha e zhvillimit, tipologjia e vendbanimeve, arkitekturat, popullsitë, infrastrukturat shoqëruese, gjeomorfologjitë dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesinkomunën e Kamenicës me PLVM janë trajtuar si më poshtë:

Zonat e ndërtimit në vendbanime:

Zonat e zhvilluara me ndërtim:

PLVM me kujdes ka identifikuar dhe trajtuar zonat ku është duke u zhvilluar ndërtimi sot nëpër vendbanime siç shihet edhe nga harta e vendbanimeve në PLVM.

Zonat e pazhvilluara me ndërtim:

PLVM-ja me kujdes ka identifikuar dhe trajtuar duke u bazuar në trendet demografike, informatat e plleshmëris së tokës pasurive nën e mbitoksore dhe informatat mjedisore edhe zonat ku mundë ndërtohet në të ardhmen nëpër vendbanime siç shihet edhe nga harta e vendbanimeve të planifikuara në PLVM. Zonat turistike

PLVM ka identifikuar zonat turistike për të gjithë llojet e turizmit të mundëshëm në komunën e Kamenicës së prezantuar në harten e turizmit.

Zona të Mbrojtura

PLVM-ja ka evidentuar gjithashtu zonën ku përfshihen zonat karakteristike me vlera të trashëgimis kulturore - historike, peisazhike, mjedisore e turistike të Komunës. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat cënojnë identitetin e zonës. Objektet ekzistuese të zonës mund të restaurohen vetëm në kushte të cilat i japin institucionet kompetente, duke mos cënuar identitetin e tyre (Kitka, dhe disa zona që shpallën të interesit komunal me PLVM).

Zona Industiale dhe zonat për zhvillime industriale

Përgjithësisht zona industrial planifikohet të jetë lokale, regjionale dhe ndërkombëtare dhe do zhvillohen kryesisht ku tashmë është krijuar një bërtham e një zone industriale ose aty ku vërtet ekzistojn kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio- ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me PLVM dhe propozuar masat mjedisore.

Pyllzimi, Zhvillimi i Pyjeve, Zonat e Blerta dhe të Pushimit

Zhvillimet në komunën e Kamenicës nuk janë shoqëruar edhe me zhvillimin e pyjeve, pyje të reja, krijimin e zonave rekreative. Në të vërtetë, shumë nga zonat pyjore, hapsirave të blerta dhe hapësirat rekreative janë cenuar

deri te shkalla e zhdukjes si pasojë prerjeve ilegale, djegjeve, zhvillimeve tjera dhe neglizhencës. Hapësira pyjore dhe masat janë planifikuar në PLVM. Deri tanishumë pak është bërë për zonat lokale rekreative apo hapësirat ku mund “të dilet për të pushuar”në vendbanime. Kohët e fundit janë bërë përpjekje për të përmirësuar gjendjen në komunë dhe rifituarhapësirat pyjore,zhvillim të pyjeve ekzistuese dhe hapsira tjera të blerta në vendbanime.

Në PLVM dy objektiva janë esenciale:

Rritja e hapsirave të gjelberta dhe

Sigurimi i koridoreve të gjelbërta që do të zhvillohen të bashkëshoqëruara me ndërtimin errugve të reja dhe atyre ekzistuese, korsive për këmbësorët dhe bicikletat dhe tampon zonave te zhvillimet industriale dhe tjera të ndjeshme.

Çështje Mjedisore që Lidhen me Mjedisin Fizik

Zhvillimi i hapsirave të rrezikuara nga erozioni të prezantuara në PLVM me harten e erozionit(erozioni i fortë) duhet të ndalohet rreptesisht në të gjitha planet në vazhdim

Zonat në të cilat ka shkarje rrëshqitje të dheut të mirren masa teknike;

Zhvillimi i zonës industriale duhet të bëhet në territorin e përcaktuar, i pa përzier me hasirat e banimit;

zhvillimet industriale duhet të zhvillohen sipas standardeve mjedisore të përcaktuara vetëm pas rivlerësimeve mjedisore;

Zhvillimi i Pyjeve, hapsirave të gjelbërta, shiritave gjelbrues dhe tampon zonave duhet të konsiderohet në çdo plan e sidomos në planet rregulluese dhe projekte duke vlerësuar raportete ndërtimit.




**Figura 10. Harta e zonave të rrezikuaR**

## Biodiversiteti, Flora dhe Fauna

Edhe Kamenica si edhe shumica e vendeve të Kosovës po përballet me problemin e humbjes se biodiversitetit. Faktori kryesor qe ka shkaktuar kërcenim serioze për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore padyshim është faktori njeri, ndërkaq shpyllëzimet masive, shfrytëzimi intensiv i tokës, ndotjet e ajrit dhe ujit dhe gjuetia e pakontrolluar janë vetëm disa nga faktorët tjerë qe vazhdojnë të rrezikojnë biodiversitetin. Nga të gjitha këto, humbja sipërfaqeve pyjore që ka përfshirë më të madhe ekosistemin natyror është një nga problemet me emergjent për natyrën e Kamenicës. Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre ka ardhur kryesisht si pasoje e shfrytëzimit pa kriter te zonave pyjore. Si pasoje e këtyre ndikimeve rrjedh edhe kërcënimi për zhdukje i shumë llojeve bimore dhe shtazore. Kafshët e rralla ne vendin tone si: Ujku, Derri eger, kaprolli, Dhelpra, dreri,dhia e egër, Macja e eger, Lepuri, Ketri, Thëllëza, shqiponja, Petriti, pata e eger, Lejleku etj, janë rrezikuar te pakësohen si pasoj e dëmtimit dhe ndryshimeve të habitateve tetyre, gjuetisë se pakontrolluar, varfërimit dhe degradimit te ekosistemeve, erozionit dhe shpyllëzimit. Për llojet shtazore është shqetësuese sidomos gjuetia e ushtruar gjatë periudhës se riprodhimit, ndërsa për llojet bimore grumbullimi i tyre gjate fazës selulëzimit, dhe nxjerrja me rrënjë.

Tipet e Habitateve

Disa nga habitatet në komunën e Kamenicës janë të klasifikuara të mbrojtura në nivel qendror dhe lokal (disa zona të identifikuara me PLVM). Ato klasifikohen si më poshtë:

Pyjet dhe zonat e e mbrojtura natyrorë;

Ligatinat;

Lumenjt;

Kullosat

Çështje Mjedisore të Lidhura me Biodiversitetin, Florën e Faunën

Ka mjaft kërcënime potenciale në manaxhimin e biodiversitetit, florës dhe faunës të komunës së Kamenicës. Çështjet në vijim janë identifikuar për zhvillim të mëtejm:

Ekosistemtet ujore (Lumi Krivareka, Lumi i Desivojcës dhe Lumi i Hogoshtit) janë të fragmentuara, të degraduara dhe, siç janë, kanë humbur habitate për specie të rëndësishme të. Gjendja e tanishme nuk siguron dot nivele të pranueshme të habitateve natyrorë;

Rritja e volumeve të ujit sipërfaqsor për pasojë ndërtimeve dhe deponimit të mbetjeve të ngurta në zonat e vendbanimeve. Kjo mund të rritë përmbytjet dhe/ose erozionin duke shkaktuar humbje direkte të habitateve;

Masa për të ruajtur biodiversitetin duke i marrë në konsideratë, në fazat e herëshme, në plane të reja zhvillimi;

Kordinimi me njësi të tjera të qeverisë qendrore me qëllim sigurimin e një brezi të gjelbërt rrugme magjistrale dhe rajonale.

**Përdorimi i Tokës dhe Peisazhi**

Planifikimi i Përdorimit të Tokës dhe Çështje të Sigurimit të Shërbimeve

Për të vlerësuar tokën si burim natyror i pa rinovueshëm dhe rolin që ka në hapsira banimi fillimisht po japin definicionin dhe funksionet bazë të saj. Toka përcaktohet si pjesa e sipërme e kores tokësore, veçanërisht komplekse, që luan rol të rëndësishëm në mjedis në zhvillimin social dhe ekonomik të cilat janë vitale për jetën. Direktiva kuadër e tokës (BE) identifikon shtatë funksionebazë të saj të cilat janë:

Prodhimi i biomasës, përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë;

Mbajtjen, filtrimin dhe transformimin e ushqyesve, substancave dhe ujit;

Mbajtëse e biodiversitetit;

Mjedis fizik dhe kulturor për njerëzit dhe aktivitetet humane;

Burim materialesh;

Si depozitë karboni;

Arkiv për trashëgiminë gjeologjike dhe arkeologjike.

Shumë nga zhvillimet e fundit në komunën e Kamenicës nuk kanë bërë një përdorim të efektshëm të tokës. Shumë nga zhvillimet e paplanifikuara nëpër vendbanime, mund të thuhet se i kanë përkeqësuar problemet e infrastrukturës dhe kanë çuar në degradim mjedisor. Shumë nga kanalizimet e furnizimit me ujë dhe të ujërave të ndotura tashmë gjenden në tokë me pronsi private, për të cilat të drejtat e kalimit e përdorimit nuk janë plotësisht të përcaktuara, duke e kufizuar kështu mundësinë e hyrjes për mirëmbajtje.

Gjithashtu, pa ndonjë plan, apo edhe vlerësim të resurseve, janë aprovuar shumë projekte të reja.Nuk është e qartë se a është bërë vlerësimi i furnizimit të mjaftueshëm me ujë dhe energji i këtyre zhvillimeve të reja.

Komuna duhet të siguroj infrastrukturën dhe shërbimet për vendbanimet. E kombinuar me një kërkes për infrastruktur dhe mobilizim më të dobët të resurseve financiare, kushtet mjedisore në komuna vazhdojnë të jenë një problem.

Si truall ndërtimi toka në territorin e komunës merr një rëndësi të posaçme; për efekt të mungesës së fondeve dhe planifikimeve, për gjatë 20 vjetëve të fundit, toka pronë publike është zvogëluar dhe prona private po dominon. Ritmet e çmimit të sipërfaqeve të konsideruara si truall kanëqënë të larta. Statuti privat dhe çmimi vështirëson sot komunën e Kamenicës të gjëjë hapsira për veprapublike. Kjo do të vazhdojë edhe më tutje duke kufizuar shpesh implementimin e PLVM-së në vepra pubilike (rrugë, lulishte, parqe).

Çështje Mjedisore që Lidhen me Përdorimin e Tokës

Përdorimi i tokës për ndërtim është në rritje dhe raporti ndërtim/sipërfaqe e gjelbërt është idisfavorshem duke krahasuar me normat europiane për etnitete me specifika të njejta;

Planifikimi i zonave ndërtimore nuk duhet të prekë sipërfaqe të gjelbërta veç në raste tëjashtezakonshme dhe duke i rikompensuar ato;

Duke pasur parasysh keto specifika, ne kapitullin 7 paraqiten masa te pershatshme per shtimine siperfaqeve te gjelbra. Per me teper, ne seksionin 7.4 paraqiten kriteret mjedisore qe kufizojne zhvillimin e ndërtimeve, qe perfshijne kriteret e forta mjedisore-shendetsore, kriteret e trashegimise kulturore, kriteret peisazhike dhe ato inxhinierike dhe te infrastruktures.

Rreziqet Natyrore në Mjedisin Fizik

Komuna e Kamenicës rrezikohet nga tërmetet. Mbështetur në hartat e rrezikut sizmik në formë probabilitare, komuna përfshihet në zonën, ku lëkundjet e truallit që janë me intensitet 8 ballë(PGA=0.2 g).

Me rritjen e ndërtimit dhe degradimit të pyjeve, rreziku i përmbytjeve do të rritet shumë.

Kjo gjë përshkruhet mëposhtë ne seksionin mbi Menaxhimin e Mbeturinave të Lëngshme dheUjërave të Shiut.

Adaptimi dhe Zvogëlimi i Rrezikut të Katastrofave, përmirësimi i informacionit dhe reagimi për zbutjen e efekteve të çdo katastrofe natyrore duhet parë me prioritet edhe atë në funksion të:

Menaxhimit të Rrezikut të katastrofës;

Forcimit të shërbimeve hidrometeorologjike;

Caktimit të kodeve të ndërtimit për aktivitetin sizmik;

Sigurimin e individeve dhe bizneseve nga katastrofat natyrore.

Mjedisi i Ndërtuar dhe Kultura

Komuna e Kamenicës është një vend i pasur me monumente kulturore-historike të lashtësisë. Monumentet e lashtësisë : Kalatë, Qytetet,Varrezat, Xhamit, Kishat etj. që gjenden në Kamenicë siç janë : Manastiri në Moçar Periudha Iliro-bizantine; Kisha e Shën Mërisë –Vaganesh; Kisha e vjetër iliro-bizantine – Hajnoc; Xhamia e Zajçecit; Xhamia e Svirces; Teqja e Topanicës; Tyrbja e Dazhnicës; Tyrbja e Rogaçicës, dhe disa objekte banimi të vjetra dhe me arkitektur autoktone. Sipas disa studimeve dhe materialit arkeologjik që është gjetur në to i përkasin dy periudhave të historisë së vjetër:

Periudha Ilire

Periudha gjatë sundimit Romak deri ne shek.V.

Cilësia e Ajrit

Është e lidhur në mënyrë përmbajtjesore me shëndetin e njeriut, me zhvillimin industrial, djegia e karburanteve, fosileve si dhe rritja drastike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit në qytetin e Kamenicës

dhe vendbanimet tjera, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze. Paralelisht me problemet shëndetësore si rezultat i ngrohjes globale paraqesin brenga të mëdha sociale.
Në mënyre te permbledhur po rendisim disa subfaktorë të cilat kanë ndikim në cilësin e ajrit në komunën e Kamenicës:
Rritja e lartë dhe përdorimi i çdokohshëm i makinave private;
Mungesa e transportit publik;
Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje meEuro I apo II;
Një pjesë e madhe e tyre punojnë me naftë dhe një pjesë e madhe e tyre janë të prodhuara nëvitet e 80-ta dhe janë të amortizuara;
Nga të gjitha rrugët që kalojnë nëpër territor të kmunës së Kamenicës, shumica janë tëasfaltuar;
Djegiet e mbeturinave në deponitë e egra;
Djegjet e pyjeve dhe mbetjeve të biomasës.

Një tjeter problem qe lidhet me cilesin e ajrit është edhe cilesia e karburanteve qe perdorin automjetet. Shumë gjeneratorë me naftë që përdoren për të kompensuar ndërprerjet e energjisë janë gjithashtu kontribues në këtë cilësi të dobët të ajrit, mbasi punojne me nafte te cilesise se dobet. Megjithate lidhur me keta te fundit, ndikimi i tyre ne cilesin e ajrit të komunës së Kamenicës, perfshire zhurmat, është minimal.
Harta në figurën më poshtë tregon zonat kryesore të ndotjes së mundshme të ajrit nga gjithë faktorët që i përmendem më lart ajrit në Kamenicë. Ato janë në rrugët kryesore ku ka përqendrim të lartë të ndotjes nga automjetet dhe zonat tjera të ndotjes.




Figura 11. Zonat nën ndikimin e mundshëm të ndotjes së ajrit

Zhurma dhe Kundërmimi

Zhurma dhe kundërmimi janë gjithashtu probleme mjedisore të cilat vazhdimisht mundë ti atakojnë popullaten duke i shkaktuar bezdisje të herë pas herëshme në disa pjesë dhe vendbanime, kurse në disa pjesë dhe vendbanime tjera në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithnjë e më shumë duke e rritë intensitetin. Vendbanimet të cilat jan vazhdimisht nën ndikim të zhurmës janë ato të cilat shtrihenpërgjat rrugëve regjionale dhe rrugëve lokale, kurse forma tjetër e bezdisjes e cila vjen nga kundërmimi vjen nga plehrat e kafshëve në vendbanime të cilat hudhen vend e pa vendë, nga fermat dhe minifermat e kafshëve të cilat janë të ndërtuara pa standarde, nga deponitë e egra të mbeturinave dhe nga kanalizimet.

Megjithate zhurma dhe kundërmimi është në të gjitha rastet përtej vlerave limit që përcakton Udhezimin "Për nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara" dhe Limitet e Pergjitheshme per Nivelin e Zhurmave te OBSH. Një tjeter dukuri për tu ven në dukje është niveli konstatnt i zhurmes gjate 24 orëve ne zonat e banimit ku limiti i nivelit te zhurmes ne oret e nates nuk duhet te kaloje 45 dBA, ndaj vlerave mbi 60 dBA.

Burimet Ujore dhe Furnizimi me Ujë

Komuna e jone eshte mjafte e pasur me uje mirepo ne munges te mjeteve per rregullimin e ujesjellsit pjesa me madhe e banoreve te komunes sone qe jetojne ne zonat rurale, furnizohet me ujete pijshem nga burimete ndryshme individuale (puse te hapura, kroje malore, lumejve) i cili nuk trajtohet ne aspektin e analizave laboratorike dhenuk eshte i verifikuar profesionalisht nga instituti ishendetit publik perveq ujesjellsit teqytetit. Komuna jone eshte e pasur me rezerva te ujit fale tri pellgjeve ujore:(pellgu I lumit te Strezovcit, Hogoshtit dhe lumit te Desivojces) si dhe pellgje te tjera me te voglate cilat kane konfiguracion me te vogel por me kualitet te mire per uje te pijshem.Poashtu kemi nje numer te vogel te fshatrave qe e kane ujesjellsin Topanicë,Karaqeve e Poshtme, lagjeja e muhagjireve Rogaçicë dhe Reqan, kurse ne ndertim e siper jane: shipashnice e Eperme Kopernice, Kolloleq, dhe KoretinBurimet ujore siperfaqesore dhe nentokesore ne territor dhe cilesia e tyre

Në Komunën e Kamenicës ka shumë lumenj, por më të rëndësishmit janë: Lumi Krivareka, lumi i Hogoshtit dhe lumi i Desivojcës . Të gjithë këta lumej derdhen në lumin Morava. Në këtë komunë ekziston dhe liqeni në fshatin Ruboc. Lumenjët e Kamenicës rrjedhje më të mëdha shfaqin gjat muajit shkurt ,mars dhe maj, kurse rrjedha më të vogla gjat muajit gusht dhe shtatorë. Sa i perket furnizimit me uje te pijshem, pjesa me e madhe e banoreve te komunes se kamenices furnizohen me uje nga puse te hapura, kroje malore, lumenje etj. Momentalisht ne funksion jane keta ujesjelles:Kamenice, Topanice, Karaqeve e poshtme dhe Reqan, Kurse ne ndertim e siper jane ne: Shipashnice e eperme, Koperrnice, Kolloleq dhe Koretin. Sistemi i Ujësjellësit në Komunën e Kamenicës. Në qytetin e Kamenicës dhe në disa fshatra ka sisteme të instaluara të ujësjellësve.

Përkundër kësaj sipas informative të organeve kompetente në Kamenicë vetëm 77% e popullatës urbane dhe 15% e asaj rurale është e kyçur në rrjetin publik të furnizimit meujë. Rreth 85% e popullatës rurale përdorë ujin e puseve të cekta dhe të pambrojtura. Siç shihet nga lart, vetëm banorët të cilët janë duke banuar në qytet furnizohen me ujënga rrjeti qendror i ujësjellësit dhe sipas informatave jo të gjithë banorët e qytetit. Humbjet teknike dhe administrative në sistemin e ujësjellësit janë shumë evidente.

Çështje Mjedisore që Lidhen me Ujin e Pijshëm

Ka raste kur cilësia e ujit kompromentohet kryesisht nga ndotjet që pëson në linjat e transmetimit (ndotja nga ujrat e e zeza, per shkak te intersektimeve te shumta te tubacionevete ujit te pishem me ato te ujrave te zeza);

Përdorimi për qëllime të tjera veç përdorimit familjar, është i madh duke ulur sasitë enevojshme për popullsinë;

Burimet ujore nëntokësore, sidomos ato deri në 20 m thellësi janë të rrezikuara nga ndotja sipërfqësore për shkak të përshkueshmerisë së larte të shtresave mbrojtëse.

Grumbullimi i Mbetjeve të Ngurta

Grumbullimi I mbetjeve të ngurta do të bëhet në deponin e planifikuar e cila ndodhet në zonënekonomike të Kërqevës;

Përfshirja të gjitha vendbanimeve në kuadër të rrjetit të infrastrukturës së grumbullimit dhemenagjimit të mbeturinave të ngurta;

Mbyllja e deponive ilegale të mbeturinave të cilat gati në të gjitha rastet janë deponi spontane dhetë paligjshme dhe ndodhen kryesisht në përfiferi të vendbanimeve rurale.

Menaxhimi i Mbetjeve të Lëngëta dhe Kullimi i Ujërave të Shirave.

Sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura në Kamenicë është si vijon:

Kështu shumë nga vendbanimet në Komunës së Kamenicë nuk kanë menaxhim efektiv të ujërave të ndotura. Janë ndërtime të paligjshme që derdhen drejt e në lumenj, të cilët shpesh janë standardit dhe rrjedhin, duke shkaktuar ndotjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nentokesore.

Mungesa e trajtimit të ujrave te ndotura përbën ndoshta rrezik të madh mjedisor për Kamenicën dhe sigurisht shkakton ndotje të madhe.

Duhet vënë në dukje se MMPH ka parapa impiant regjional në Gjilan për trajtimin e ujrave të zeza konfiguracioni i terrenit të Kamenicë nuk paraqet ndonjë përpasi në ketë funksion përpos në segmente të caktuara.

Furnizimi me Energji

Furnizimi me energji bëhet nga KEK-u. Ndërprerjet e vazhduara të energjisë elektrike kane qenë shqetesuese vite më parë edhe se me trend të zvogluar por prapë paraqesin një shqetsim. Kjo sillte dhe vazhdon të siejell si pasojë përdorimin e gjeneratorëve me naftë, që rendonte ndotjen e ajrit dhe që po vazhdon kohë pas kohe.

Aktivitetet Ekonomike dhe Sociale

Ekonomia ne Komunen e Kamenicës është ne gjendje mjaft te vështirë. Shumica e nderrmarjeve janë tregtare, pak prodhuese, te cilat punojnë me kapacitete te vogla. Këto ndermarrje nuk kan mund mi rrit kapacitetet prodhuese dhe numrin e punëtorve. Procesi i privatizimit nuk ka dhënë rezultate te pritura. Mungesa e mjeteve financiare, kushtet e pavolitshme te kreditimit,politika fiskale joadekuate, stimulimi jo i mjaftueshem ne bujqësi janë problem për bujqësi e gjithashtu direct ne ekonomi. Industria është ne nivel te ulet, dhe te ardhurat nga kjo sfer janë te ulta.

Punsimi është nji prej sfidave per autoritetet vendore si dhe nuk shihet ndonji perpjekje per hapjen e kapaciteteve te cilat do te punsonin nji numer me te madh te punëtorve e veqanerisht te rinjëve dhe grave si kategori më te prekura.Migrimi drejt qytetit apo depopullimi i zonave rurale,ne nenyrë direkte po ndikojnë ne zvoglimin e numrit te fermave. Një nder problemet është edhe se te rinjet nuk duan te miren me bujqësi. Te rinjet ma teper jon te orijentuar te migrojnë jasht vendit, kurse te vjetrit nuk munden me punu ne bujqësi ne mënyren e duhur.

Komuna e Kamenices ka resurse per zhvillimin e pemtarisë perimtarisë, blektorisë, bletarisë, per prodhimin e mishit, shpeztarisë si dhe duhet te kemi parasysh resurset pyjore te cilst mundësojn kultivimin e frutave tem alit dhe bimëve mjekuese te cilat mund te luajnë nji rrol te konsiderueshem ne zhvillimin e bujqesisë.Meqe nji siperfaqe e konsiderueshme janë pyje, kjo na mundeson zhvillimin e flores dhe faunes. Pozita gjeografike e komunes na jep mundësi te komunikimit te njerëzve te mallit dhe kapitalit me disa komuna te zones kufitare si Medvegja, Bujanoci e tj. Gjuetia është mjaft e zhvilluar. Prodhimi i mjaltit dhe produkteve tjera te mjaltit mund

te jap rezultate te mira pasi qe kemi njohes te mi rte kesaj veprimtarie si dhe kushtet klimatike dhe laramania bimore krijojn kushte te mjaftueshme per kultivimin e bletve. Mund te mendohen edhe menyra per kultivimin e peshkut, pasi lumenjt e pershkojn komunen ne dy anet e saj.

Parimet, objektivat dhe kriteret mjedisore

Parimet e Pergjithshme per Planifikim Hapesinor

Parimet e pergjithshme per planifikimin hapesinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombetare, të cilat shkurtimisht mund të përmblidhen në dhjetë pika si më poshte:

Nxitja e zhvillimit te qëndrueshëm;

Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;

Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejzazhore, të florës e faunës;

Zhvillim i shëndetshëm mjedisor, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve;

Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;

Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan" ose „përdoruesi paguan";

Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira per mbrojtjen e mjedisit;

Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe pergatitjen e sheshit;

Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe aksesi i publikut në informacion; dhe

Bashkëpunim ndërkombëtar.

Ne kuader te hartimit te PLVM-së parimet e mesiperme përkthehen në përparesitë e meposhtme (siç jane paraqitur edhe në këtë material):

Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar;

Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës;

Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve– aksesi nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;

Rehabilitimi i tokës bujqësore;

Rizhvillimi i pyjeve kzistuese, pyllzime të reja;

Ruajtja e trashëgimisë kulturo – historike dhe natyrore të Kamenicës;

Ruajta e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;

Zgjerimi i zonav të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

Objektiva Strategjike

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë idefinuar si: Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryera të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;

Cilesia e ujrave siperfaqesore në përputhje me kerkesat e legjislacionit të Kosovës dheDirektives në kuader për Ujin të BE-së;
Pakesimi i sasise se mbetjeve dhe manaxhimi i integruar i tyre;
Reduktimi i intesnsitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësordhe qarkullimit me bicikleta;
Shtimi dhe mbrojtia e vlerave kulturore, perfshire arkeologjike dhe arkitekturore;
Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
Mbrojtia e mjedisit natyror në pyjet dhe malet;
Riperdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.
Veprime Operacionale ne Mbeshtetje te Objektivave Strategjike
Veprime operacionale për shtimin e hapesirave te gjelbra në komunën e Kamenicës:
Krijimi i projekteve për zbatim në zonat të cilat do të mbrohen me këtë plan;
Pyllëzimi dhe ripyllzimi i zonave të parapara me PLVM ;
Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për reth vendbanimeve;
Krijimi i koridoreve te reja ekologjike sipas Planit te ri dhe zonave të Kamenicës zgjatimi dhepermiresimi i kushteve ekologjike në koridorin pergjate lumejve;
Krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe kopshteve në Kamenicë, etj;
Kthimi i zonave te degraduara ne siperfaqe te gjelbra;
Gjelberimi i kopshteve te shtepive private;
Gjelberimi me peme dhe shkurre dekorative pergjate rrugeve dhe trotuareve;
Ngritja e barrierave të dendura me gjelberim si perde që ndajn rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjate rrugeve me trafik të dendur me qellim te shumefishte (rritje gjelberimi, permiresim cilesise se ajrit permes filtrimit te pluhurave, si edhe rritje e sigurise rrugore).
Veprime operacionale për përmiresimin e sistemit të transportit dhe shtimit të përmbajtjeve:
Ndertimi i një rrjeti rrugor që lidhin Kamenicën (me interest e vacant me Prishtinën) dhe me rajonin;
Permiresim i gjendjes së rrugeve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundesise;
Krijim i rrjetit të plote rrugor në vendbanmet e mëdha me përmbajtje edhe për biciklistet dhe kembesorët;
Permiresim i sistemit, orareve dhe cilesise se autobuzeve;

Permiresimi i projektimit te rrugeve me parashikimin e trotuareve të plota dhe shiritave/korsive për bicikletat sipas standarteve europiane të rrugëve;

Kriteret Mjedisore që Kufizojnë Zhvillimin Komunal

Me poshte paraqiten disa kritere mjedisore që duhet të kufizojne zhvillimin komunal, të grupuara në kater kategori kryesore, perkatesisht (1) kriteret e forta mjedisore-shendetsore, (2) kritere te trashegimise kulturore, (3) kritere peisazhike dhe (4) kritere inxhinierike dhe te infrastruktures.

## Kritere të Forta Mjedisore-Shendetesore

Keto kategori kriteresh percaktojne zonat e perjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura te natyres), (II) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si "hot-spote" mjedisore (psh. mbetje kimike).

Zonat me vlera të veçanta mjedisore zona të tilla nuk ka.

Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

Shtrterit e lumejve dhe pjeset buferike rreth tyre (lumi Krivareka, lumi Hogoshtit, dhe disa rrjedha te rendesishme ujore);

Basenet nentokësore ujëmbajtëse;

Zonat me pjerresi më të madhe së 15 apo 20%.

Nuk lejohen ndertimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmbytjeve (qofte dhe shume të rralla), mund te shkaktojne erosion të brigjeve, si dhe të cenojnë rregjimin hidrologjik te sistemit ujor.

Ne menyre të ngjashme, nuk lejohen ndertimet në zonat me pjerresi të madhe pasi në mjedis argjilor keto ndërtime mund të shkaktojne (ose përkeqesojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Në ketë fazë të Planit Zhvillimor Komunal është vështirë të përcaktohen me detaje këto zona, por gjate hartimit të këtij plani është punuar një planë me pjerrëtësi dhe gjatë zhvillimeve të ardhëshme mundë të superpunohet me informata tjera dhe të shfrytzohet si bazë për plane rregulluese dhe projekte tjera.

Zona të ndotura të njohura si "hot-spote" mjedisore (psh. mbetje kimike) perfshijne:

Deponia e e egra pëgjat lumenjve dhe kanalizimet që derdhen drejt per drejt ne lumenj;

Thertore dhe objektet tjera te veprimtarisëekonomike;

Nderrmarja e riparimit të automjeteve;

Deponit e veturave "varrezat e veturave".

"Varrezat e kafshëve"

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlersimin e situates mjedisore mbi bazen e tecilit do te mund te gjykohet mbi nivelin e ndotjes së ujit dhe tokes dhe masat eventuale qe duhen nderrmare për rehabilitimim.

Kritere të Trashegimise Kulturore

Komuna e Kamenicës ka objekte të trashegimise kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturore dhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar.

Vlerat e trashegimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qellim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin eqendrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor.

Zona si Manastiri në Moçar Periudha Iliro-bizantine; Kisha e Shën Mërisë –Vaganesh; Kisha evjetër iliro-bizantine – Hajnoc; Xhamia e Zajçecit; Xhamia e Svirces; Teqja e Topanicës; Tyrbja e Dazhnicës; Tyrbja e Rogaçicës, duhet ruajtur si zone me vlera arkeologjike dhe turistike. Sugjerohet vijimi i kërkimeve arkeologjike dhe zhvillimi në respekt të funksionit kryesor kulturor. Duhet që zona historike-etnografke të bëhet e vizitueshme nga publiku (zone kembesore) dhe mundesisht të krijohen elemente turistike që rrisin vlerat e këtij lokaliteti historik, psh. muze, dyqane suveniresh, dyqane tradicionale dhe të veçanta, zona sherbimi, etj.

Lista e monumenteve të kultures do duhet rishikuar dhe lehtesuar ndjeshem. Disa prej monumenteve te kultures jane cenuar, tjetersuar apo zhdukur. Disa prej monumenteve kane qene shpallur për motive qartesisht politike dhe lista duhet avancuar.

Ka disa zona tradicionale me vlere konservimi qe mund të mbrohen. Duke pasur vlera të ndërtimit tradicional, këto zona turistike duhet ruajtur me karakter të veçant. Zonat ose objektet krysore që dueht mbrojtur janë: Manastiri në Moçar Periudha Iliro-bizantine; Kisha e Shën Mërisë – Vaganesh; Kisha e vjetër iliro-bizantine – Hajnoc; Xhamia e Zajçecit; Xhamia e Svirces; Teqja e Topanicës; Tyrbja e Dazhnicës; Tyrbja e Rogaçicës.




Figura 13. Harta e Trashëgimisë kulturor

## Kritere Peisazhike

Komuna e Kamenicës ka vlera të larta pejsazhike të llojeve të ndryshme si peizazhe që krijonë pyjet dhe malet që shtrihen në Jug dhe Lindje, livadhet dhe fushat që shtrihen luginën e lumit të lakuar, luginat e përthyra malore si dhe veprat humane si vendbanimet. Kriteret peisazhike janë më të vështirëpër të përcaktuar pasi duhen konsideruar rast pas rasti dhe duhen caktuar në bashkepunim dhe pajtueshmeri me institucionet tjera.

Zona me vlera te larta peisazhike në të cilat nuk duhet te lejohet ndertimi perfshijne:

Planica, Kika, Velegllava, Tugjeci të cilat kanë vlera të larta peisazhore;

Lumi Hogoshtit dhe lumi i Lakuar (Kreivareka) e në pjesen më të madhe të segmentit qëpërshkon i pasur me peizazhe atraktive;

Peizazhet bujqësore që shtrihen në zonën e luginave lumore, sidomos te lumi i Lakuar(Kreivareka);

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për t"i mbrojtur sa më mirë, intervenimet e njeriut në pikat skenike-atraktive, duhet të minimizohen. Posaçërisht, në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit. Shkaktarët kryesorë të degradimit të peisazhit janë minierat sipërfaqësore (gurthyesit), djegjae pyjeve dhe prerja e pakontrolluar e tyre.

Duke pasur parasysh se Ligji i Planifikimit ngarkon komunat me përgatitjen e planeve hapesinore, nderkohe që Kamenica edhe se ka përgatit ketë planë duhet që të gjejë mirekuptim dhe bashkepunim me Institucionet tjera kompetente dhe akterët tjer për nevojen e mos-lejimit të ndertimeve në keto zona, qofte duke e sanksionuar kete edhe me akt-normativ.

Kritere Inxhinierike dhe të Infrastrukturës

PLVM-ja duke trajtuar shfrytzimin e tokës, mjedisin, nfrastrukturen dhe fushat tjera si ajo e zhvillimit ekonomik dhe socialofron një mundësi të zhvillimeve të qëndrueshme nëse merr në konsideratë posaçërisht sistemin inxhinierik dhe nevojat e infrastruktures së komunës si pjesë integrale dhe i trajton në sistemin multishtresor për të menjanuar konfliktet eventuale dhe ofruar zgjidhje të qendrueshme.

Planifikimi i ndërtimit të korridoreve të qarkullimit të nivelit nacional dhe internacional që lidhë Kosovën me Serbinë, duhet kihet parasysh tri elemente kryesore:

Paisja me impiante filtrimi dhe pastrami të ujrave ndotës që shkarkohen, konkretisht me "laguna";

Vendosja e barierave të zhurmës në afërsi të vendbanimeve;

Të krijohen më shumë rrugë lokale në mënyrë që shkalla e fragmentimit social dhe mjedisorë të jetë më e vogël.

Duke qenë se Transportit mbeshtet kryesisht në cilësinë e transportit publik me autobuzë dhe promovim nëpër vendbanime edhe shfrytzimin e bicikletave dhe udhtimin këmbë, PLVM-ja duhet të marre parasysh tipin e

sistemit rrugor të planifikuar dhe ndertesat qe mund te ngrihen duhet te respektojne nje largesi te mjaftueshme nga sistemi rrugor, perfshi trotuaret apo korsite e bicikletave sipas rastit.

Në mënyrë të ngjashme, projekti i vendndosjes së kolektorit të ujrave të ndotura, trajtimit të përkohëshëm të ujrave të ndoturanë nivel komunal,të vendbanimeve apo të lagjeve (sipas Planit për Ujin dhe Trajtimin e Ujrave te Ndotura brenda PLVM-së) duhet zbatuar atë që është përfshirë në PLVM-në, dhe ajo përmbajtje duhet evidentuar në sistemin GIS-it. Edhe ndërtimet e mundshme duhet të respektojnë një largesi të pranueshme. Sistemi ujësjellsit dhe kanalizimit duhet monitoruar për të parandaluar rrjedhjet, rinovuar sipas nevojes dhe futur nëntokë sipas standarteve dhe duke u shënuar problemet në sistemin GIS që shoqeron PLVM-në.

Gjithashtu, linjat e transmetimit të energjisë, dhe ato të telefonise fikse do duhet të rekonstuohen, avancohen dhe sa më shumë të futen nëntokë dhe të shenohen në sistemin GIS-it që shoqëron PLVM-ja. Natyrshem ndërtesat e reja do duhet të respektojne distance të pranueshme nga keto linja, sipas kritereve të dhëna në PLVM. Antenat e telefonise celulare nëpër vendbanime është mire të jenë të grupuara dhe jo të shperndara, megjithese kjo çështje është e veshtire të trajtohet në kuader te PLVM-së. Mendojme që problemi i antenave duhet të jetë objekt i një studimi të veçantë, përfshirë ndikimin eventual në shëndetin e njeriut.

Duke pasur parasysh që mbetjet mbeshteten në sistemin e trajtimit të mbetjeve sipas hierarkiseRedukto-Riperdor-Riciklo-Djegie-Vend depozitim duhet që PLVM-ja të pasqyroje ketë parim dhe të planifikoje zonat e pershtatshme për vendndodhjen e zones së riciklimit dhe mundesisht të parashikojezona qe mund të perdorën për djegie apo pikë transiti për të ardhmen, duke konsideruar me perparesi ndikimin ne mjedis.

Ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat për zbutjen e tyre.

## Komuna e Kamenicës dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit

PLVM-ja është rezultat i evidentimit, vlerësimit, dhe prioritizimit të nevojave strategjike zhvillimore socio-ekonomike dhe mjedisore të Komunës së Kamenicës dhe komunitetit të saj nga ana e Grupit hartues të Planit Zhvillimor komunal. PLVM ka si qëllim transpozimin dhe sendërtimin e Vizionit, të këtyre objektivave dhe prioriteteve strategjike në një sistem planifikimi zhvillimor komunal. Në një proces të tillë të rëndësishëm, ky itinerar do të mbështetet nga hartimi i planeve tjera të vendbanimeve dhe zonave ndërtimore të niveleve më të ulta dhe kodeve me instrumente të veçanta zhvillimi hapësinor, sipas gjithë komponentëve të vet: ekonomikë, socialë, mjedisorë dhe organizativ. Këta instrumente përbëjnë një ndërthurje të programeve të veprimit me nismat investuese, me qëllim orientimin e zhvillimit komunal në zonën e përfshirë në studim.

Plani merr në konsideratë dhe përgjithësisht është në përputhje me planet e ndryshme të nivelit më të lartë, si dhe në linjë edhe me shtyllat kryesore të zhvillimit të Planeve Sektoriale, Planet dhe projektet Sektoriale që hartohen edhe si rezultat i këtij plani duhet të bëjnë ose të parashikojë të përfshijë vlerësime të kostove dhe të identifikojë ose përfshijë identifikimin e masave të nevojshme qëduhen ndërmarrë për implementimin e këtyre propozimeve. Propozimet për zhvillimin zonave, rrugëve etj, përfshihen si në propozimet për përdorimin e tokës, ashtu edhe për ndarjen në faza, pasi duhet që të ruhen apo të gjenden sipërfaqe toke për zhvillimin e zonave, ndërtimin e rrugëve etj, përsa kohë që mundësia e aksesit shihet si mekanizmi kryesor që drejton zhvillimin.

Qështje tjetër që PLVM trajton janë zonat me vlera mjedisore dhe ambientale si dhe zonat me vlera të trashëgimisë kulturore si dhe janë marrë masa adekuate për mbrojtjen e këtyre zonave me rëndësi të veçant. Si rezultat, PLVM do të shërbejë edhe si një proces i cili mundëson adresimin e shumë prej problemeve mjedisore socilae, ekonomike dhe organizative të cilat kërkojnë zgjidhje të duhur. Kryesisht duhen investime në infrastrukturë dhe përmirësim i menaxhimit komunal me qëllim që tu jepet përgjigje shumë prej problemeve mjedisore të hapësirës komunale të marrë në studim, ndërsa procesi i planifikimit të zhvillimit të zonave dhe shfrytëzimit të tokës duhet zbatuar sipas këtij plani, me qëllim që të parandalohet shtrirja e mëtejshme nëpër zonat bujqësore dhe zonat me vlera tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Kjo nevojë për planifikim dhe menaxhim në nivel vendbanimesh të shumta bashkërendimi dhe veprimi në mes tyre është identifikuar si çështje e rëndësishme edhe në raportet e PLVM-së, sipas së cilës gjithashtu propozohen masa për mbrojtjen e zonave ekzistuese të gjelbra dhe ujërave brenda dhe rreth territorit komunal dhe ka përgatitur planin e masave për zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. Këtu përfshihen zonat e ujrave sipërfaqsore, përgjatë lumenjve, dhe nëpër vendbanime.

## Plani Zhvillimor

### Trajtimi i Qështjeve Mjedsore në Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Gjatë hartimit të Planit në çdo fazë të zhvillimit të tij është vënë në konsiderat edhe vlerësimin mjedisor. Megjithëse nuk është qëllim kryesor për PLVM-në, të dalurat e fazës së parë të studimit të PLVM-së (faza e profilit komunal) përmbajnë të dhëna dhe komente të konsiderueshme mbi gjendjen dhe problemet e mjedisit në Kamenicë. Gjatë fazave te zhvillimit të PLVM-së merren në konsideratë çështje mjedisore apo të ofrimit të shërbimeve dhe diskutojn gjendjen dhe shkakun e problemeve mjedisore në komunë.

Zhvillimet e planifikuar të cilat kanë ndikim në mjedis janë marrë në konsiderat duke i ruajtur të gjitha komponentet mjedisorenë aspektin strategjik të zhvillimit të komunës. Gjatë planifikimit gjithmon janë ruajtur korridoret e qarkullimit të shtazëve dhe bimëve nga një ekosistem në tjetrin,janë ruajtur ekosistemet të cilat kanë një rëndësi të veçant për komunën dhe për rajonin, janë marr në konsiderat ruajtja e zonave të mbrojtura me vlera ambientale dhe kulturore.

## Analiza e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PLVM-së

Gjatë analizës është vlerësuar se masat të cilat janë marrë për mbrojtje të mjedisti gjat planifikimit nuk do të kenë efekte negative ekonomike apo shëndetësore dhe mjedisore. Për këtëarsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë plani mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi, të cilat janë edhe objekt i VSM, janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të planit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky plan. Tabela e mëposhtme shërben si një listë e kontrollit të kritereve mjedisore sipas të cilave është bërë vlerësimi i këtij plani. Kjo listë tregon nëse PLVM-ja e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetëkështu, nëse i ka dhënë përgjigje. Kolona e fundit shpjegon nëpërmjet shenjave si më poshte:

*= Ka përgjigje të plotë për problemin;

 += Ka nevojë për masa të mëtejme;

- = Nuk është trajtuar, duhet të trajtohet me PLVM.

**Tabela 5. Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të PLVM-së**

| **Tabela nr. 5. Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të PLVM-së** | | | |
|---|---|---|---|
| **Kriteri përkatës** | **Aështëmarrëparasys** | **Si është trajtuar problemi në PLVM ?** | **Treguesi** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | hnëPLVM? | | |
| 1. Përfshirja e konsideratave mjedisore | Po | Përfshihen në seksionet e mëposhtme. | * |
| 2. Përfshirja e konsideratave shëndetsore | Po | Përshkruhen në seksionet e mëposhtme. | * |
| 3. Marrja parasysh e objektivave ndërkombëtarë, kombëtarë dhe lokalë për mjedisin dhe shëndetin gjatë formulimit të PLVM-së | Po | Përshkruhen në seksionet e mëposhtme. | * |
| 4. Përfshirja në sintezë e KonsiderataveMjedisore | Po | Janë përfshirë në PLVM. | * |
| 5. Konsideratat mjedisore në Opsione | Po | Kjo është bërë si pjesë e diskutimve profesionale gjat studimit të skenarëve zhvillorë. | * |
| 6. Koncepti i Planifikimit të PLVM-së | | | |
| a. Mbështetje për zhvillimin policeentrik me infrastrukturë të zhvilluar të Kamenicës | Po | Propozimi ndjek në mënyrë pragmatike prirjet ekzistuese dhe ato strategjike të zhvillimit komunal dhe socialo ekonomik të Kamenicës. Problemi është që kjo rritje të bëhet mbi bazën e kritereve të forta mjedisore, dhe të mos shtrihet në tokat bujqësore, pyjet përreth, | * |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | hapsirat ujore dhe me potencial vërshimi si dhe jo në afërsi të zonave të mbrojtura. | |
| b. Afirmon rolin e Kamenicës në nivel të Kosovës, dhe në nivel ndërkombëtar krahas ofrimit të mundësive turistike që ofron komuna | P o | Orienton Komunën e Kamenicës si qendër dhe si pikë fokale për të gjitha anet e venditnë kuptimin e zhvillimit të turizmit dhe fuqizimit të trashëgimis me vlerat e | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | trashegimis natyrore dhe kulturore. | * |
| d. Përforcimi i kapacitetit të Komunës për të rritur rolin e migrimit dhe për t"u siguruar banorëve të rinjë mundësi punësimi. | P o | Kjo propozohet të bëhet nëpërmjet zgjerimit në hapësirë në vendbanimet që kanë trende rritje dhe ofrimit të kushteveedhe në vendbanimte tjera. | * |
| e. Integrimi i zonave rurale në komunë dhe ulja e shkallës së përjashtimit ekonmik dhe social të banorëve të tyre. | P o | Është marr në konsideratë që në fazën enismës së hartimit të PLVM-së. | * |
| f. Fuqizimi dhe zgjerimi i vendbanimeve brenda kufinjve ndërtimor të planifikuar | P o | Ky koncept ka si qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe rigjenerimin e vendbanimeve në sistemin policentrik. Ai përfshin propozime mjedisore në formën eruajtjes së zonave të gjelbra edhe përtej kufijve ndërtimor të vendbanimeve | + |
| g. Harmonizimi dhe barazpeshimi i zhvillimve nëpër nënqendra komunale. | P o | Ky propozim ka si qëllim zhvillimin e nënqendrave të tjera për të ulur stresin në një zonë qendrore. Si i tillë, ai propozon ndërtimin e një serie funksionesh nëpër këto nënqendra. | * |

| | | | |
|---|---|---|---|
| h. Fuqizimi i zonave ekonomike ekzistuese, si dhe zonave të reja ekonomike përgjat akseve rrugore në përgjigjje të potencialeve dhe nevojavetë reja ekonomike. | P o | Ky koncept ka si qëllim të mbështesë por dhe orientojë dhe përkufizoj zhvillimet aktuale. Koncepti mbështet në faktet që gjendja tashmë e krijuar është e patjtërsueshme, kështu duhet sanuar duke orientuar zhvillimet dhe përkufizuar zonat. | * |
| i. Të gjitha potencialet ekonomike janë vë në shërbim të zhvillimit të komunës, duke vu theksin në mundësit zhvillimore në zonat ekonomike për biznset e vogla, të mesme dhe të mëdha. | P o | Vizion i ri ka për objektiv të gjejë mundësi që zonat e njohura ekonomike dhe turistikenë komun të mund të shfytëzohen racionalisht dhe të ofrohen si një paket turistike shum atraktive. | * |
| j. Ruajtja e shtretërve dhe rrjetit të lumenjëve në tërësi (me theks të veçant lumi Lakuar (krivareka) dhe lumi i Hogoshtit etj). | P o | Ky koncept dhe kjo ndërhyrje ka për objektiv mbrojtjen e disa zonave ujore brenda hapëirës së Kamenicës, dimesionimi i zonës sipas kritereve mjedisore, dhe zgjidhja e një problemi të fortë mjedisor të zonës | * |
| k. Ruajtja ujërave nëntokësore të cilatndodhen në Kamenicë | P o | Problematika është trajtuar në pjesën e analizave të gjendjes ekzistuese, është trajtuar edhe në masat të cilat janë vë si rezultat i ofrimit të shërbimeve komunale. | * |
| m. Përmirësimi i shërbimeve publike dhe | | Po, por duhet arritur një ekuilibër mes aksesit të përmirësuar dhe inkurajimit të | * |

| | | | |
|---|---|---|---|
| aksesit ndaj transportit në zonat rurale | | zhvillimit të mëtejshëm te ndertimeve rurale në zonat ku kjo gjë mund të mos jetë e dëshirueshme. | |
| 7. Ndikimet në klimë | | | |
| a. Përshtatja me ndryshimet klimatikeglobale. | Jo | Ka trajtim trajtim të ndryshimeve klimatike globale. Ndërsa ende nuk ka strategji nacionale të aprovuar për masat | - |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | që duhet marr për tu përshtatur me ndryshimet klimatike globale. Nuk është objekt parësor i parashikuar nga TeR, por në studimin mjedisor janë integruar objektiva dhe instrumenta zbatimi të cilat shkojnë në këtë drejtim siai i uljes së $CO_2$ të komunës. | |
| b. Marrja parasysh e ndryshimeve lokale. | P o | Përfshihet si tregues mjedisor, por nuk trajtohet në mënyrë parësore. | + |
| 8. Demografia | | | |
| a. Problemet me zhvillimin demografik | P o | Njeh faktin se kjo është ende e vështirë për t‟u parashikuar saktë. Megjithatë, mund të ketë nevojë për më shumë fleksibilitet, për t‟i lënë hapësirë ndryshimeve të mundshme. | + |
| b. Skenarët e zhvillimit demografik | P o | Merr parasysh faktin që popullsia mund të rritet jo edhe aq shumë deri në vitin 2025. PLVM-ja i mban larg presionit demografik zonat me ndjeshmëri mjedisore. | * |
| 9. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i Tokës | | | |
| a. Planifikimi komunal dhe Drejtimi iZhvillimit | P o | Njeh nevojën për pranimin e zhvillimit | * |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | aktual, përveç zonave ku mund të shkaktohen probleme mjedisore | |
| b. Kapacitetet mjedisore në zonat dhe vendbanimet e propozuara për zhvillim | Po | Vlerësohet se vetëm në pjesët e ndryshme ku kemi eksploatim të rërës dhe degradim të lumenjve dhe disa deponi të vjetra të mbeturinave, i rrezikojnë kapacitetin e saj mjedisor dhe ekologjik. Ndërsa në vendbanime nuk ka një cenim ekologjik, duke qenë brenda kapaciteteve mjedisore. Zona e propozuara për zhvillim industrial apo ekonomik shtrihet në tokën jobujqësore dhe propozohet studimi i VSM/VNM-së së veçant për aspektet tjera mjedisore, ndërsa në vendbanimet brenda konceptit policentrik vrehen tendencat e shtrirjes në kategorinë "tokë bujqësore" tëkonvertuara vonë në zona informale, por edhe këtu tentohet të ruhet sa ma shumë tokë bujqësore dhe kompaktsim sa ma i madhë i zonës ndërtimore. | * |

| | | | |
|---|---|---|---|
| c. Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave tëreja rekreative | Po | Njeh problemin e mungesës së tokës për ketë qëllim vetëm brenda vendbanimeve dhe propozon mbrojtjen e zonave të gjelbra dhe parqeve duke krijuar një kurorë të gjelbër të përbërë nga disa zona dhe sisteme kodrinore malore të mbrojtura. Megjithatë, për të gjithë këta elemente, përfshirë dhe zonat që gjendën brenda vendbanimeve (zemrat e gjelbërta) dhe në zonat jashtë tyre janë të | + |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | përcaktuara kufijtë. Duhen marrë vendimet përkatëse për shpalljen zona të interesit komunal, dhe duhen aprovuar Planet e Menaxhimit lidhur mezhvillimet brenda këtyre kufijve. | |
| d. Zhvillimi i parqeve të reja brenda vendbanimeve policentrike | P o | Edhe se pjesërisht e thamë më lartë se njohim problemin e mungesës së tokës brenda zonës së vendbanimeve poliicentrike. Në disa vendbanime janë parapar edhe disa zona të blerta të ashtuquajtura si “zemrat e gjelbërta” në të cilat mundë të zhvillohen parqe dhe hapësira për zhvillim të bujqësisë intensive. PLVM propozon një varg masash për rritjen e sipërfaqes së gjelbër. Masat duhet të konkretizohen me veprime për çdo kategori zonash në vedbanime. | * |
| e. Mbrojta e pyejeve, peisazheve dhe zonave të mbrojtura natyrore | P o | Njihen problemet dhe bëhen propozimet adekuate për pyjet dhe hapësirat e gjelbra. Duhet çuar përpara statusi i tyre dhe duhet hartuar dhe aprovuar Plane menaxhese përkatëse, ndërsa parqet | * |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | ekzistueseduhet trajtuar në mënyren adekuate në tërë territorin e komunës. | |
| f. Zhvillimi i zonave të reja komunale | P o | Nxitet ky zhvillim veçanërisht në fushen e hapsirave dhe terreneve sportive, për të lehtësuar presionin në disa vendbanime. Me zhvillime të reja janë tashmë të gjitha vendbanimet me elemente të domosdoshme urbene. | * |
| g. Zhvillimet industriale | P o | PLVM i përputhet me parimet strategjike ku aktivitetet ekonomike që shkaktojnë ndotje nuk do të lejohen dhe do të dekurajohen. Ka një problem me trajtimin e zhvillimeve aktuale për këtë lloj industrie! | + |
| i. Shërbimet dhe lehtësirat Publikë (shkolla, stadiume sportive) | P o | Propozon norma dhe nevojën për standarde në tër territorin e komunës. | * |
| h. Pyjet, malet dhe parqet/zonat embrojtura | P o | Trajtohen si zona të mbrojtura për pyje dhe parqe. Dekurajohet me forcë ndërtimi në kto zona për pos kur është definuar | + |

| | | | |
|---|---|---|---|
Komuna e Kamenicës ka probleme të mjaftueshme mjedisore, të cilat vijnë si rezultat i keq menaxhimit të resurseve natyrore dhe keq menaxhimit të hapësirave publike. Ndërkohë që popullata ekomunës së Kamenicës ka një traditë të kujdesit për mjedisin dhe hortikulturën me kultivimin e bimëve dekorative dhe të krijimit të parqeve dhe zonave të gjelbërta. Problem tjetër është prerja e pa kontrolluar e pyjeve që si rezultat pasojnë probleme tjera zinxhirore deri te ndikimi edhe në klimën rajonale. Andaj hartimi dhe zbatimi rigoroz i PLVM-së dhe sugjerimeve të cilat u dhanë në VSM në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në mjedis. Ai do të orientojë rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të komunës së Kamenicës me qëllim dendësimin në zonat që janë të pastabilizuara ende dhe të zhvillojë zona të reja banimi dhe shërbimesh të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve aktuale në komunën e Kamenicës. Ai gjithashtu do të ruajë trashëgiminë e ndërtimit, krahas nxitjes së një peizazhi me pamje më të këndshme. PLVM-ja do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribuoj në mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve në të gjitha zonat pyjore dhe parqeve brenda dhe rreth vendbanimeve, krahas aspektit të rëndësishëm të parandalimit të depërtimit (shtrirjes) në tokat e pëlleshme bujqësore përreth. Përfitimet kryesore të këtij plani lidhen kryesisht me përdorimin në mënyrë me efikase të tokës.

Janë marrë parasysh parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor të bazuar mbi eksperiencat ndërkombëtare, si nxitja e zhvillimit te qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejsazhere, zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, etj.

Zbatimi praktik i parimeve te përgjithshme në rastin e PLVM-së nxjerr disa përparësi si psh. Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikim përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes përtej vijave cilat kufizojnë ndërtimin, strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe historike, ruajta e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme.

PLVM-ja përpiqet të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuara gjerësisht përfshi:

Komuna e Kamenicës si komunë e cila përballon nevojat për banim të banorëve të saj dheturist nga jashtë vendit;

Komuna e Kamenicës komunë e shëndetshëm me peizazhe dhe ekosisteme interesante;

Komuna e Kamenicës komunë policentrike (koncepti i diellit);

Shtimi i sipërfaqeve te gjelbra duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe zhvillimin,krijimin e pyjeve, korridoreve ekologjike dhe tampon zonave në Kamenicës;

Zgjerim te rrugëve por dhe nxitjes se ecjes këmbësore dhe me bicikleta;

Përmirësim transportit publik (përmirësim i shërbimit te autobusëve);

Zgjerim i vendbanimeve me trendë pozitive në drejtimin të tokave me plleshmëri më të dobët

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në Kamenicës, rritjen e sigurisë, shtim të mundësive për mënyrë aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj. dhe duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

VSM sugjeron disa veprime operacionale konkrete per ruajtjen e vlerave mjedisore dhe vlerave tjera te trashëgimise.

Veprime operacionale në Kamenicës:

Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura sipas PLVM në komunën e Kamenicës siç janë: me vlera të veçanta natyrore për komunën (Planica, Kika, Velegllava, Tugjeci) Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të parapara me PLVM, krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për rreth vendbanimeve; zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike

në korridorin përgjatë lumenjve;krijimi i lulishteve dhe kopshteve në qytetin e Kamenicës; kthimi i zonave të ndotura në sipërfaqe të gjelbra; gjelbërimi me pemë dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve; ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qellim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit te pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore); trajnim i grupeve të ndryshme të cilat merren me mbrojtje dhe sensibilizim të vlerave mjedisore. Veprimet në infrastrukturë: ndërtimi i një rrjeti rrugor që lidhin Kamenicën me rajonin; përmirësim i gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundësisë; krijim i rrjetit të plote rrugor në vendbanimet e mëdha me përmbajtje edhe për biçiklistet dhe këmbësoret;
përmirësim i sistemit, orareve dhe cilësisë së autobusëve; përmirësimi i projektimit te rrugëve me parashikimin e trotuareve të plota dhe shiritave/korësive për biçikletat sipas standardeve europiane të rrugëve;

Plani do të jetë një mekanizëm që ofron zgjidhje për zhvillimin e komunës. PLVM-ja duhet të fuqizoje komunën të luaje rol me aktiv mes palëve për të ofruar mundësi për të mos mbetur peng i mosmarrëveshjeve mes palëve.

VSM gjithashtu i vendos disa kufizime zhvillimit që parashikohet nga PLVM-ja. Kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal janë (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, (2) kritere të trashëgimisë kulturore, (3) kritere peisazhike dhe (4) kritere inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Kriteret e forta mjedisore-shëndetësore përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (i) zona me vlera te veçanta mjedisore (psh. parqet), (ii) zona të rrezikshme për zhvillim (pjerrtësi të mëdha, shtrat lumi, etj.) dhe (iii) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. zona te ndotura me mbetje kimike, akumulatore. Nuk lejohet gërmimi në zonat “hot spot” mjedisore pasi zhvillimi i zonës mund të cenojë integritetin e shtresave të ujërave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund te kaloje në shtresat nëntokësore dhe mund të shkaktojnë sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonës në fjalë. Në zonat e ndotura rekomandohet inkapsulimi i tyre duke i kthyer në zone të gjelbra me vlerë rekreative.

Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë zbatimit të PLVM-së. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Monitorim i zbatimit te PLVM-së dhe parametrave mjedisore te tij do jetë kyç i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Me hartimin dhe hyrjen në fuqi të PLVM-së arrihet një hap cilësor në planifikimin e qëndrueshëm të territorit dhe burimeve natyrore, por puna nuk përfundon këtu. Hartimi i Planeve rregulluese dhe projekteve tjera do duhet të sigurojë përfshirjen e faktorëve mjedisorë gjatë detajimittë planeve në nivel më të ulët gjatë zbatimit te PLVM-së. Përveç pikave të renditura më sipër, ka nevojë që hartimi i Planeve Rregulluese të shërbejë për të përcaktuar dhe siguruar kufijtë e zonave të gjelbra, si edhe për të identifikuar dhe zhvilluar hapësira të vogla çlodhëse dhe rekreativo sportive në vendbanime.

Rekomandimet që dalin nga VSM-ja:

Studime mbi gjendjen e biodiversiteti dhe i habitateve natyrore në komunën e Kamenicës;

Definimi i korridoreve ekologjike gjatë realizimit të rrugëve të planifikuar si dhe atyre të ndërtuara siç është rasti me propozimin e urës kaluese të shtazëve në autoudhë;

Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave me potenciale rrezatimi, por edhe planifikimi i mundësive për trajtimin e rrezatimit jonizues në vendet ku është goditur me bomba në luftën e fundit mendohet të paraqitet si një burim vazhdueshëm i ndotjes në komunën e Kamenicës;

Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e Erozionit dhe vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;

Definimi i zonave ekonomike në aspektin e tipit të industrisë apo afarizmit dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishme të zonave duke ofruar bazat për trajtim të zonave ekonomike me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;

Të bëhen projekte duke u bazuar edhe në PLVM vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si masë të rëndësishme mjedisore;

Projekte për rehabilitim të zonave, vijave ose mundësisht edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi transite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera;

Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujërat nëntokësor dhe sipërfaqësor;

Konservimi i veçorive natyrore (Monumentet e Natyrës) si objekte natyrore dhe si zona;

Definimi i peizazheve, parqeve me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave;

Projekt për ngrohjen kolektive të qytetit të Kamenicës por edhe vendbanimeve;

Projekte për caktimin e zonave të zhurmës;

Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.

# LITERATURA

Agjencia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit për vitin2010;

Komuna e Kamenicës. 2019 Hartat e prezantuar në PLVM;

Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2013;

Raporti për gjendjen e natyrës 2015-2017;

Raport mbi menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë 2018;

Raporti i Mbuleshmerisë së Sipërfaqes së Tokës, CLC 2018;

Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2017;

Ernest A. LoËe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries;

Agenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.

Environment, Health and Safety Resource Centre Limited, 2014, Environmental Impact

Assessment Study for the Proposed Eastern Industrial Park Njiru area, Nairobi County

Parlamenti Evropian/Direktiva e Këshillit SEA. [WWW dokument] URL: Aktet Ligjore: http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0042:EN:NOT

Dalal-Clayton, D., Sadler, B. (2005). Vlerësimi Strategjik Mjedisor: libër i të dhënave dhe udhëzues rreth përvojës ndërkombëtare. Earthscan, SHBA

Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrjedhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998. [WWWdokument] URL: http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf

Ligji i Kosovës mbi Planifikimin Hapësinor. [WWW dokument] URL: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_14_en.pdf

Ligji i Kosovës mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor. [WWWdokument]URL:
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-230-eng.pdf

Qendra Rajonale Mjedisore për Evropën Qendrore dhe Lindore, REC. (2000). Analiza Strategjike Mjedisore e Kosovës. Zyra e REC në Kosovë, Prishtinë. URL: http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia mbi Menaxhimin e Mbeturinave 2011-2020). Prishtinë, 2011

The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, REC. (2000). Strategic Environmental Analysis of Kosovo. REC field office in Kosovo, Pristina. http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF

The UNECE Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (EspooConvention),1991.WWWdocument] RL:http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia për Mjedisin 2013-2022).Prishtinë, 2013

American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;

Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches;

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 6569
Nr. i faq. Br. str. 07 Data: Datum: 20/03/2025
KAMENICË/A

KUVENDI KOMUNAL KAMENICË

DRAFT RREGULLORE NR.__________

PËR PLOTËSIM NDRYSHIM TË RREGULLORES SH.01 NR.31251 E DATËS 29.09.2022
PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURËN E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

Shkurt, 2025

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c), nenit 40 paragrafi 40.2, shkronja a) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale i Repubikës së Kosovës në harmoni me dispozitat e nenit 70 shkronja h) të Statutit Sh.01 Nr.2023 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës dhe nenit 12 të Rregullorës Nr.01/2013 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve Komunale, Kuvendi I Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më …….. miratoi këtë:

**RREGULLORE PËR PLOTËSIM NDRYSHIM TË RREGULLORES SH.01 NR.31251 E DATËS 29.09.2022 PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURËN E NDARJES SË SUBVENCIONEVE**

**Neni 1**
**Qëllimi**

Me anë të kësaj Rregullore plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja Sh.01 Nr.31251 e datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve

**Neni 2**
**Përjashtim nga ndarja e subvencioneve**

Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, pas nën nën pargrafit 3.3.1 shtohet nën nën pargrafi 3.3.2 me tekstin si në vijim:

3.3.2 Përjashtim nga nën nën pargrafi 3.3.1 bën subvencionimi i qumështit/litër

Neni 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1.1 Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëjnë subvencionet e ndara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale tek subvencionet për Mirëqenie Sociale specifikisht për subvencionet në Nenin 26, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1.

**Neni 3**
**Vendimmarrja**

Neni 11, paragrafi 2, shtohet nënparagrafi 2.1 me tekstin si në vijim:

2.1. Ndaj vendimeve për ndihma momentale në fushën e shëndetësisë nuk lejohet e drejta e ankesës.

**Neni 4**
**Subvencionet në fushën e Arsimit**

Neni 15 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Komuna mund të ndaj subvencione për arsim, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, në:

1.1 Bursa për studentë;
1.2 Bursa për nxënës të shkollës së mesme;
1.3 Bursa për nxënës të shkollës fillore;
1.4 Kuadro deficitar;
1.5 Nxënësit me nevoja të veçanta;
1.6 Botimin e librave dhe revistave;

2. Përfitues I subvencionit në arsim është nxënësi që në garat individuale :

2.1 në nivel komunal zë vendin e parë, shpallet "Ylli I Shkollës" dhe shpërblehet me shumën 50 euro.
2.2 në nivel komunal zë vendin e dytë, merr lëvdatë dhe shpërblehet me shumën 30 euro.
2.3 në nivel komunal zë vendin e tretë, merr lëvdatë dhe shpërblehet me shumën 20 euro.
2.4 në nivel regjional-republikan zë vendin e parë, shpallet "Yll i Dardanës" dhe shpërblehet me shumën 100 euro.
2.5 në nivel regjional-republikan zë vendin e dytë, merr lëvdatë shpërblehet me shumën 80 euro.
2.6 në nivel regjional-republikan zë vendin e tretë, merr lëvdatë dhe shpërblehet me shumën 60 euro.

3. Përfitues I subvencionit në arsim është nxënësi që në garat grupore:

3.1 në nivel komunal zënë vendin e parë, marrin lëvdatë dhe shpërblehen me shumën 20 euro për nxënës.

3.2 në nivel komunal zënë vendin e dytë, marrin lëvdatë dhe shpërblehen me shumën 15 euro për nxënës
3.3 në nivel komunal zënë vendin e tretë, marrin lëvdata dhe shpërblehen me shumën 10 euro për nxënës.
3.4 në nivel regjional-republikan zënë vendin e parë, shpallen "Yll i Dardanës" dhe shpërblehet me shumën 30 euro për nxënës.
3.5 në nivel regjional-republikan zënë vendin e dytë, marrin lëvdatë dhe shpërblehet me shumën 25 euro për nxënës.
3.6 në nivel regjional-republikan zënë vendin e tretë, marrin lavdatë dhe shpërblehet me shumën 20 euro për nxënës.

4. Mësimdhënësi, nxënësi/t i/e të cilit:

4.1 merr lëvdaten "Yll i Shkollës", shpërblehet me shumën 100 euro.
4.2 shpallet "Yll i Dardanës" shpërblehet me shumën 300 euro.
4.3 zë vendin e dytë ose të tretë në garat regjionale-republikane shpërblehet me shumën 200 euro.

5. Nxënësit fitues dhe mësimdhënësit do të shpërblehen vetëm një herë dhe atë për rezultatin më të lartë të arritur.
6. Mjetet do të barten në llogari të mësimdhënësit përkatës të nxënësit/ve garues i cili do ta dëshmoj tek Drejtoria e Arsimit për ndarjen e të hollave tek nxënësi/t

7. Mësimdhënësi, që perveç detyrave dhe obligimeve që përshkruhen në kontratë të punës, harton, aplikon dhe fiton:

7.1 Donacion për shkollën në vlerë mbi 1000 euro, shpërblehet me shumën 100 euro.
7.2 Donacion për shkollën në vlerë mbi 3000 euro, shpërblehet me shumën 200 euro.
7.3 Donacion për shkollën në vlerë mbi 5000 euro, shpërblehet me shumën 400 euro.

8. Nxënësi që merr lëvdatën YLL I DARDANËS i garantohet bursa në vitin e parë të studimeve.

9. Shkolla me performancën më të lartë në nivel komunal shpërblehet me një udhëtim jashtë Kosovës.

Neni 16, paragarafi 1 nënparagrafi 1.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta:
   1.1 Për student:
      1.1.1 Nota mesatare, prej 9 deri në 10 ..........................................30 pikë
      1.1.2 Nota mesatare, prej 8 deri në 9 ..........................................20 pikë
      1.1.3 Nota mesatare, prej 7 deri në 8 ..........................................15 pikë
      1.1.4 Nota mesatare, prej 6 deri në 7 ..........................................10 pikë
      1.1.5 Studentet të cilët kanë fituar në garat sipas nenit 15 pika 2.................10 pikë

**Neni 5**
**Subvencionet në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

Neni 26, paragrafi 3, nënparagrai 3.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3.1. Familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar

Neni 26, paragrafi 3, shtohet nënparagrafi 3.5 me tekstin si në vijim:

3.5 Përkrahje financiare për viktimat e dhunës në familje

Neni 26, paragrafi 10, shtohet nënparagrafi 10.1.3 me tekstin si në vijim:

10.1.3 Përjashtim nga nënparagrafi 10.1.2 bën prindi vetëushqyes i cili duhet të jetë banor i komunës së Kamenicës

Neni 26, shtohet paragrafi 13 dhe 14 me tekstin si në vijim:

13. Përkrahje financiare për viktimat e dhunës në familje

13.1 Subvencionimi ndahet në tre (3) komponente:
13.1.1 Subvencionimi i banimit .............90 euro/muaj
13.1.2 Subvencionimi i mjeteve për jetesë (aplikohet kur viktima nuk është përfituese nga skema e ndihmës sociale)....................75 euro/muaj
13.2Përfituesit e subvencioneve nga paragrafi 13 i këtij neni jo domosdoshmërisht mund të jenë përfitues nga dy komponentet.

13.3 Ky subvencion mund të ofrohet në një afat prej 6 muajve i cili mund të vazhdohet jo më shumë se 2 vite por i njëjti mund të ofrohet edhe në një afat më të shkurtër, por e njëjta mund të ndërpritet edhe më herët se sa është përcaktuar paraprakisht, sipas vlerësimeve të Qendrës për Punë Sociale dhe Komisionit përkatës.

13.4 Qendra për Punë Sociale bën propozimin pranë Komisionit përkatës për ndërprerjen e përkrahjes financiare për shkak të ndryshimit të rrethanave si në vijim:

13.4.1 Punësimi/rikthimi në marrëdhënie pune;
13.4.2 Bashkimi familjar;
13.4.3 Ndryshimi i vendbanimit;
13.4.4 Ndryshimi i statusit martesor;
13.4.5 Të gjitha rrethanat e tjera që e vlerëson QPS-ja.

14. Dokumentet e nevojshme për aplikim për ndarje të subvencioneve e përcaktuara në paragrafin 13 të këtij neni janë:

14.1.Dokumenti i cili dëshmon se rasti është i hapur në Polici;
14.2.Dokumenti i cili dëshmon se viktima ka paraqitur Kërkesë për urdhër mbrojtje apo procesverbali, vendimi i gjykatës (opsionale);
14.3.Dokumenti i identifikimit;
14.4.Certifikatat e fëmijëve
14.5.Certifikata e bashkësisë familjare
14.6.Konfirmimi bankar;
14.7.Kontrata e noterizuar e banimit;
14.8.Dëshmi apo referim nga Strehimorja (opsionale);
14.9.Konstatim Zyrtar nga QPS-ja.

**Neni 6**
**Monitorimi i përfituesve të subvencioneve**

Neni 29, paragrafi 4 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

4. Komuna në bazë të komisionit të monitorimit të cilin e formon Kryetari i Komunës harton raporte me listën e zezë për përfituesit të cilët nuk e kanë respektuar marrëveshjen për subvencionim si dhe saksione tjera.

Neni 29, paragrafi 4 i shtohen nënparagrafet 4.1 dhe 4.2 me tekstet si në vijim:

4.1 Të caktohet një zyrtar përgjegjës për krijimin e databazës së listës së zezë i cili ka për detyrë ta mirëmbajë dhe rifreskoj atë pas cdo subvencionimi dhe monitorimi nga Komuna e Kamenicës.

4.2 Lista e zezë të shpërndahet tek të gjitha komisionet vlerësuese të sektorëve te ndryshëm për subvencionim pas cdo rifreskimi të listës.

Neni 29, shtohet paragrafi 5 dhe 6 me tekstin si në vijim:

5. Komuna në bazë të raportit të monitorimit ofron afat shtesë prej 30 ditësh për përfituesit të cilët nuk kanë realizuar projektin.

6. Komuna do të marrë masa ndëshkimore të cilat specifikohen në marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët , në rast të mospërputhjes së projektit dhe afatit shtesë sipas paragrafit 5 të këtij neni.

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr./Br. 02 4816
Br. str. 1
Data/Datum: 28.02
KAMENICË/A 2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Zyra e Kryetarit**

Në mbështetje te nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 paragrafi 5.1 shkronja h), neni 40 dhe neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) dhe paragrafi 70.2 shkronja a) si dhe neni 82 i Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _________2025, sjell këtë:

**PORPOZIM VENDIM**
**Për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike**

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për vendosjen e trafos elektrike.

2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71107063-00977-1, në zonën kadastrale Poliqkë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 187246 $m^2$, e evidentuar në posedim të Kuvendit Komunal Kamenicë.

3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, të ndahen $9m^2$ (nëntë metra katror), për vendosjen e trafos elektrike, poashtu, është dhënë pëqimi parimor nga KEDS Nr.1969 e datës 19.02.2025 për rregullim të dokumentacionit teknik për pëlqim elektroenergjetik.

4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Kamenicës dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barrë tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjenca dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ- arkivi.*

**Kryetar i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

| KEDS | NJËSIA E SHËRBIMEVE ME KONSUMATORË | Nr. | KEDS-DCC-F-DCC-04 |
|---|---|---|---|
| | | Faqe | Faqe 1 nga 2 |
| | PËLQIM ELEKTROENERGJETIK | Versioni | 1.0 |

**Për aplikuesin:** Shqiponjë Bashkim Pira
"Tasneem AG" L.L.C.

**Adresa:** Poliçkë, Kamenicë

KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM ME ENERGJI ELEKTRIKE - KEDS SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION COMPANY - KEDS J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU ELEKTRIČNOM ENERGIJOM - KEDS D.D.
KEDS - SH. A.
Nr. 1969 Dt. 19 FEB 2025
PRISHTINË VIII

**Lënda:** 27[I]2025
**TIC:** 1757319

Përmes Arkivës
Prishtinë (Qendër)

# PËLQIM ELEKTROENERGJETIK

## A. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME.

Veprimtaria: Fabrikë e ujit
Numri i njësive: **1 njësi**
Fuqia e Transformatorit: $S_{inst}$ = **160 kVA**
Fuqia maksimale e njëkohshme: $P_{mnj}$ = **118.9 kW** **(sipas projektit elektrik)**

## B. KUSHTET TEKNIKE

1. Nënstacioni i KEDS prej nga do te furnizohet objekti: TS 110/20(10) kV "Kamenica"
2. Niveli i tensionit ne pikën e kyçjës: 10(20) kV
3. Dalja 10(20) kV prej nga do te furnizohet objekti: "J01 Hogoshti me kod: 62000001"
4. Vendi i pikës kyçëse: Linjë ajrore 10(20)kV.
5. Vendi i pikës(t) matëse: Në panelin e ri 0.4 kV të TS-it të ri.
6. Mënyra e kyçjës, sipas zgjidhjes teknike të bashkangjitur me këtë Pëlqim Elektroenergjetik.

## C. KUSHTE TE PËRGJITHSHME.

1. **Ekzekutimi i kyçjes** të bëhet sipas normave teknike. Paraprakisht, projektit elektrik i kyqjës së bashku me listën e përzgjedhur te pajisjeve dhe materialeve elektrike të planifikuara për tu përdorur duhet të aprovohen nga Departamenti i Investimeve në KEDS. Pajisjet e vendosura duhet te jene te reja dhe në përputhje me standardet IEC/ISO.
2. **Pika e kufirit të përgjegjësisë**. Kufiri i përgjegjësisë do të mbetet pika matëse respektivisht dalja nga njehsori.
3. **Transferimi i aseteve**. Të gjitha asetet që do të ndërtohen sipas definimit nga ky Pëlqim Elektroenergjetik dhe të vendosura para pikës matëse, do të transferohen në pronësi dhe shfrytëzim me të drejta të plota nga KEDS-i. Këtu përfshihen: *Linja e tensionit të mesëm prej pikës kyçëse deri te nënstacioni e ri, nënstacioni i ri me të gjitha pajisjet, linja e tensionit të ultë deri te pika matëse.*
Për asetin e ndërtuar nga aplikuesi dhe të transferuar në KEDS, sipas këtij PEE nëse kërkohet te kycet nje aplikues i ri atëherë kompensimi do te behet sipas metodologjisë se taksave te kycjes se OSSH-se te aprovuar nga ZRRE. Kostoja e aseteve te ndërtuara përcaktohet ne hapat e ardhshëm per te cilën vlere do te mund te kompensoheni ne te ardhmen sipas metodologjisë se taksave te kycjes.
4. **Mirëmbajtja e aseteve** KEDS do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e aseteve deri te pika matëse, ndërsa pas kësaj pike është përgjegjësi e aplikuesit.
5. **Për çdo rritje të fuqisë** elektrike në objekt, konsumatori është i obliguar që nga KEDS, Divizioni i Shpërndarjes të kërkojë pëlqim elektroenergjetik plotësues.
6. **Kapaciteti i kërkuar** sipas këtij PEE, rezervohet pasi të bëhet pagesa për taksat e kyçjes (pika F).
7. **Ky pëlqim elektroenergjetik vlen në afat** prej 365 ditësh. Pas këtij afati, nëse nuk ka pranim teknik, KEDS nuk është i obliguar te lëshoj pëlqim me kushte te njëjta, fuqia e rezervuar për këtë PEE nuk do te garantohet.

| KEDS | NJËSIA E SHËRBIMEVE ME KONSUMATORË | Nr. | KEDS-DCC-F-DCC-04 |
|---|---|---|---|
| | PËLQIM ELEKTROENERGJETIK | Faqe | Faqe 2 nga 2 |
| | | Versioni | 1.0 |

## D. PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT, SIGURIMI I LEJEVE DHE AUTORIZIMEVE T DOMOSDOSHME

1. Për të vazhduar tutje me fazën e aprovimit të projektit te kyçjes dhe aprovimit te materialit, Aplikuesi është obliguar që të posedojë këtë dokumentacion:
   a. Projektin Elektrik të kyçjes (2 kopje fizike)
   b. Formularin e Leje-Hyrjes respektivisht regjistrin e punëtorëve që do të kryejnë punët bashkë m emrin e organizatës së licencuar si dhe regjistrat e automjeteve të angazhuar në kryerjen e punëve
   c. Formularin për Aprovim te projektit.
   d. Fletë-dëftesat mbi prejardhjen e materialeve, ndërsa
2. Për te vazhduar tutje me fazën e pranimit teknik, Aplikuesi është i obliguar që të posedojë këtë dokumentacion:
   a. Kërkesën zyrtare për pranimin teknik.
   b. PEE dhe zgjidhja teknike;
   c. Projekti elektrik i kyçjes i aprovuar nga KEDS;
   d. Lejet e institucioneve përkatëse si dhe autorizimet noteriale nga pronaret e pronave private;
   e. Formulari i Leje-Hyrjes i aprovuar;

## E. UDHËZIME DHE INFORMATA TE PËRGJITHSHME:

1. Ky Pëlqim jepet se bashku me zgjidhjen teknike dhe janë te pavlefshme njëra pa tjetrën.
2. KEDS duhet të ketë qasje 24/7 të papenguar, në mënyre që të kryej inspektime rutinë te aseteve me qellim te mirëmbajtjes, kontrollimit dhe investimit/zgjerimit/përforcimit të rrjetit deri në dalje të pikës matëse.
3. Projekti i kyçjes si dhe realizimi i punëve duhet të punohen nga kompania-organizata e licencuar për punë të këtilla.
4. Kyçjen e objektit të Aplikuesit duhet ta kryejnë punëtorët e Divizionit të Shpërndarjes pasi të është kryer pranimi teknik i elementeve të Shpërndarjes.
5. Shpenzimet e përpilimit të dokumentacionit teknik, zgjidhjes së çështjeve pronësore-juridike dhe ndërtimit të aseteve energjetike sipas pëlqimit dhe zgjidhjes teknike i bartë aplikuesi.
6. Gjatë eksploatimit të energjisë elektrike konsumatori duhet të mbajë faktorin e fuqisë $\cos\varphi \geq 0.95$ duke montuar bateritë kompensatorike.
7. Ekzekutimi i punëve do të mbikëqyret nga Divizioni i Shpërndarjes.
8. Instalimi i objektit – kantierit, tokëzimi mbrojtës dhe punues duhet të bëhet sipas rregullave teknike.
9. Aplikuesi deklaron se ka kuptuar kushtet e pëlqimit. Aplikuesi deklaron se do t'i përmbahet kushteve dhe se merr përgjegjësi për të gjitha devijimet nga këto kushte, përveç se në rastet kur përgjegjësia është e palës së tretë.
10. Aplikuesi deklaron se është i vetëdijshëm për pasojat e shkeljes së pëlqimit dhe se pranon hapjen e procedurave në rast të shkeljes eventuale.

## F. TAKSAT E KYCJES:

| | |
|---|---|
| Taksa për shërbimet e kyçjes në 10 kV | 83.00 |
| Taksa për aprovim të projektit | 30.00 |
| TVSH sipas ligjit | 20.34 |
| | **Total = 133.34 €** |

Me Respekt,

Udhëheqës për PEE
Veton BYLYKBASHI

Menaxher për SHK (KEDS)
Blerton MUSTAFA

Drejtor i DSHK (KEDS)
Sabri TËRNAVA

KEDS SH.A. PRISHTINË

*Ekzemplar: 1X Palës; 1X Menaxherit për SHK; 1X Arkivit*

Pala

**KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË SH.A.**
**KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION COMPANY J.S.C.**
**KOSOVSKO PREDUZECE ZA DISTRIBUCIJU ELEKTRICNOM ENERGIJOM D.D.**

| | |
|---|---|
| Adresa - Address : | [Prishtine, Bulevardi Bill Klinton no.5, 10000] |
| Nr. bizn. - Buss. No. : | 810799364 |
| Nr. fisk. - Fisc. No. : | 810799364 |
| Nr.TVSH - VAT. No. : | 330169905 |
| Nr.Xhir. - Accou. No./SWIFT : | BKT: 1901844100031180/NCBAXKPR |
| Web: | www.keds-energy.com |
| Nr.Tel. - Phone No. : | 038 501101-1455 |
| Nr.Fax. -Fax No. : | _/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/_/ |

KEDS - SH. A.
Nr. 136 Dt. 08 JAN 2025
PRISHTINË VIII

# FATURA- INVOICE

Nr. i faturës - Invoice No.
**1757319/2025**

Përshkrimi i faturës - Invoice Description
**Taksa e kyçjes dhe shërbime tjera**

Data e faturës - Invoice Date
**06.01.2025**

**Përcaktuesit - Determinants**

Kontrata - Contract : 1757319
Detajet e aplikuesit - Applicant details: PEE
Per. e dërges.- Delivery period :
Afati i pages.- Paymet deadline: 06.01.2025

**Të dhënat e klientit - Client data**

Emri i klientit- Client name : Tasneem AG L.L.C.
Nr. Fiskal - Fiscal No. : 812200088
Nr. i biznesit - Bussines No.: 812200088
Nr. i TVHS - VAT No. :
Adresa - Address : Morava, Taulantët, nr.4
Telefoni - Phone :

Lista e detajeve - List of Details

| Nr. No. | Emri i produktit Item Description | Njësia matëse Unit | Sasia Quantity | Çmimi për njësi Unit price | Vlera Neto Net Amount | TVSH-ja VAT | Vlera Gross An |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pregatitja e pelqimit elektroenegjetik | Copë | 1.00 | 25.0000 | 25.00 | 4.50 | |
| 2 | Pergatitja e ofertes per Kyqje | Copë | 1.00 | 50.0000 | 50.00 | 9.00 | |
| 3 | Për Zgjidhje Teknike | Copë | 1.00 | 70.0000 | 70.00 | 12.60 | |

| | |
|---|---|
| **Subtotali - Subtotal:** | **145.** |
| **TVSH-VAT 8%:** | **0.** |
| **TVSH-VAT 18%:** | **26.** |
| **Totali - Total (€) :** | **171.** |

**Komenti - Comment**

**Faturoi - Calculated:**

**Menaxheri-Manager:**

KEDS SH.A. PRISHTINË VIII

**Pranoi - Accepted:**

1

Software By SI

KEDS

NJËSIA E SHËRBIMIT ME KONSUMATORË

FORMA E URDHËRPAGESËS

| | |
|---|---|
| Nr. | KEDS-DCC-F-DCC-03 |
| Faqe | 1 prej 1 |
| Versioni | 1 |

Rruga Bill Clinton, nr.5 -10000

10 000, Prishtinë, Kosovë

Nr. Fiskal : 810799364
Nr. Biznesit : 810799364

Nr. **1757319**

Data : **20.02.2025**

# URDHËR PAGESË PËR TAKSA E KYÇES DHE SHERBIME TJERA

133.34 €

Njëqindë e tridhjetë e tri euro e tridhjetë e katër cent

Emri i klientit / Biznesit : Shqiponje Bashkim Pira/Tasneem AG L.L.C

Adresa: Poliçkë,Kamenicë

Nr. Identifikues / Fiskal : X9342074/812200088

Banka ku bëhet pagesa : BKT

Numri i llogarisë bankare: **1901844100031180**

Përgatitur nga: Alberina Bajraktaraj

Aprovuar nga : Blerton Mustafa

Pranoi:

KEDS

NJËSIA E SHËRBIMIT ME KONSUMATORË

FORMA E URDHËRPAGESËS

| | |
|---|---|
| Nr. | KEDS-DCC-F-DCC-03 |
| Faqe | 1 prej 1 |
| Versioni | 1 |

Rruga Bill Clinton, nr.5 -10000

10 000, Prishtinë, Kosovë

Nr. Fiskal : 810799364
Nr. Biznesit : 810799364

Nr. **1757319**

Data : **20.02.2025**

# URDHËR PAGESË PËR TAKSA E KYÇES DHE SHERBIME TJERA

133.34 €

Njëqindë e tridhjetë e tri euro e tridhjetë e katër cent

Emri i klientit / Biznesit : Shqiponje Bashkim Pira/Tasneem AG L.L.C

Adresa: Poliçkë,Kamenicë

Nr. Identifikues / Fiskal : X9342074/812200088

Banka ku bëhet pagesa : BKT

Numri i llogarisë bankare: **1901844100031180**

Përgatitur nga: Alberina Bajraktaraj

Aprovuar nga : Blerton Mustafa

Pranoi:

| KEDS | NJËSIA E SHËRBIMEVE ME KONSUMATORË | Nr. | KEDS-DCC-F-DCC-08 |
|---|---|---|---|
| | | Faqe | Faqe 1 nga 3 |
| | ZGJIDHJE TEKNIKE | Versioni | 1.0 |

**Për aplikuesin:** Shqiponjë Bashkim Pira
"Tasneem AG" L.L.C.

KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM ME ENERGJI ELEKTRIKE - KEDS SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION COMPANY - KEDS J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA DISTRIBUCIJU ELEKTRIČNOM ENERGIJOM - KEDS D.D.
KEDS - SH. A.
Nr. 1969 Dt. 19 FEB 2025
PRISHTINË VIII

**Lënda:** 27[I]2025
**TIC:** 1757319

**Adresa:** Poliçkë, Kamenicë

Përmes Arkivës
Prishtinë (Qendër)

## Zgjidhja Teknike

Në bazë të kërkesës së aplikuesit TIC: 1757319, Divizoni i rrjetit jep zgjidhjen teknike në bazë të kushteve të cekura më poshtë:

### A. MËNYRA E KYÇJES

Furnizimi i trafostacionit të ri me energji elektrike duhet të bëhet nga LP 10(20)kV dalja **"J01 Hogoshti me kod: 62000001"** prej TS 110/20(10) kV "Kamenica". Ekzekutimi i kyçjes së trafostacionit të ri të bëhet në shtyllën ekzistuese të drurit e cila paraprakisht duhet të ndërrohet me shtyllë të re të betonit e tipit **SHB 12/1600** *(shih zgjidhjen teknike faqe 3 )*. Nga shtylla kyçëse e deri te trafostacioni i ri duhet të realizohet linja e re 10(20)kV përgjatë rrugës publike sipas projektit elektrik të aprovuar paraprakisht nga Departamenti i Investimeve në KEDS. Ekzekutimi i kyçjes, ndërtimi i linjës së re 10(20)kV, ndërtimi i TS-it të ri të bëhet sipas normave teknike dhe projektit elektrik i cili paraprakisht duhet të aprovohet nga Departamenti i Investimeve në KEDS. Trafostacioni i ri TS 10(20)/0.4 kV duhet të jetë me fuqi instaluese **Sn=160 kVA** i tipit "Trafo-Shtyllë" me të gjitha pajisjet adekuate për këtë tip të trafostacionit dhe i ndërtuar në vend të përshtatshëm me mundësi të qasjes së përhershme. Pjesa e tensionit të ulët 0.4 kV duhet të ketë ndërprerës automatik të fuqisë **AS-250 A** me mbrojtje nga mbingarkesa, dalje të mjaftueshme 0.4 kV për furnizimin e objektit si dhe baterinë kompenzatorike me mundësi të ajrosjes. Kyçja e objektit të ri nga paneli i ri TU 0.4 kV të trafostacionit të bëhet me dalje të veçantë me ndërprerës automatik dhe nga dalja e veçantë të realizohet linja 1 kV deri tek KSHE e objektit sipas projektit elektrik të aprovuar paraprakisht nga Departamenti i Investimeve në KEDS. Realizimi i punimeve dhe i kyçjes të bëhet sipas normave teknike. Projekti i realizimit të punimeve (pikës kyçëse, ndërtimi i linjës së re 10(20)kV, konstruktimi i TS-it të ri, shtrirja e kabllos 1 kV, kyçja e objektit në anën 0.4 kV të TS-it të ri) duhet të aprovohet në Departamentin e Investimeve-KEDS. Të gjitha pajisjet elektrike të vendosura në LP, TS dhe 0.4 kV duhet të jenë të reja dhe në përputhje me standardet IEC/ISO, njëkohësisht të gjitha pajisjet elektrike dhe projekti elektrik duhet të aprovohen nga Departamenti i Investimeve në KEDS.

**Vërejtje:**

- Të respektohen distancat e sigurisë ndaj objekteve gjatë shtrirjes së kabllove dhe ndërtimit të TS-it të ri.
- Në fazën e aprovimit të projektit në Departamentin i Investimeve KEDS, për realizimin e punimeve, investitori duhet të definoj trasenë (rrugën) për tek trafostacioni i ri e cila duhet të jetë publike asisoj që KEDS të ketë çasje të përhershme për menaxhim dhe operim të linjës 10(20)kV dhe të TS-it të ri.

### B. MATJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Matja e energjisë elektrike për objektin e ri të bëhet me metodën gjysmë indirekte me njehsor elektrik multi-funksional (aktiv, reaktiv dhe maksigraf) 3x230/400V, 5A, me grup tarifor "6/6" përmes transformatorëve matës rrymor me koeficient transformimi **200/5 A/A** të shkallës së saktësisë 0.5 S klasë 10(15)VA FS5. Përçuesit rrymor nga TMRR deri në njehsor të përzgjidhen me 6 (gjashtë) ngjyra/etiketa të ndryshme me seksion bakër 4 mm² dhe të vendoset në gyp të veçantë. Përçuesit e tensionit deri në njehsor të përzgjidhen me 3 (tri) ngjyra/etiketa të ndryshme me seksion 2.5 mm² dhe të vendosen në gyp të veçantë. Njehsori elektrik dhe TMRR-të duhet të vendosen në panelin e ri TU 0.4 kV të trafostacionit me mundësi të çasjes së përhershme për lexim. Njehsori elektrik të jetë i prodhuar sipas direktivës MID dhe njehsori të jetë i pranuar nga MTI e Republikës së Kosovës. **Njehsori elektrik do të sigurohet nga KEDS në fazën e pranimit teknik, kur objekti t'i plotësojë kushtet për energjizim.**

## C. UDHËZIME DHE INFORMATA TE PËRGJITHSHME

1. Kjo zgjidhje teknike ashtu sikurse pëlqimi elektroenergjetik i bashkangjitur vlen në afat prej 365 ditësh. Pas këtij afati, nëse nuk ka pranim teknik, KEDS nuk është i obliguar te lëshoj pëlqim me kushte te njëjta, fuqia e rezervuar për këtë PEE nuk do te garantohet.
2. Kjo zgjidhje teknike jepet së bashku me Pëlqimin Elektroenergjetik dhe janë te pavlefshme njëra pa tjetrën.
3. KEDS duhet të ketë qasje 24/7 të papenguar, në mënyre që të kryej inspektime rutinë te aseteve me qellim te mirëmbajtjes, kontrollimit dhe investimit/zgjerimit/përforcimit të rrjetit deri në dalje të pikës matëse.

Me Respekt,

| Udhëheqës për PEE | Menaxher për SHK (KEDS) | Drejtor i DSHK (KEDS) |
|---|---|---|
| Veton BYLYKBASHI | Blerton MUSTAFA | Sabri TËRNAVA |

KEDS SH.A. PRISHTINË

*Ekzemplar: 1X Palës; 1X Menaxherit për SHK; 1X Arkivit*

## D. ZGJIDHJA TEKNIKE (E PROPOZUAR)

ZGJIDHJA TEKNIKE – Shqiponjë Bashkim Pira "Tasneem AG" L.L.C.
Lënda: 27[I]2025, TIC: 1757319



# E. SKEMA NJEPOLESHE




| TS/TR | Sins (MVA) | Linjë kabll. (km) | Linjë ajrore (km) |
|---|---|---|---|
| 42/42 | 6.16 | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. / Od. 07 Nr. / Br. 4571
Nr. i faq. / Br. str. 1 Data: / Datum: 25/02/2025
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMI HAPËSINOR**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Datë/a | | | Nr. 4535 datë 25.02.2025 | | |
| REFERENC-Ë: | | | **Sh07-351/01-0004535/25** datë **25/02/2025** | | |
| PËR/ZA/TO: | | | **Tasneem AG.LLC/ Shqiponjë Bashkim Pira** | | |
| CC: | | | Në dosje të arkivit | | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | | | Uran Berisha , Drejtori i DUPH-së | | |
| NGA/OD/FROM: | | | Mehmet R. Thaçi, Udhëheqës i Sektorit të Urbanizmit | | |
| TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT: | | | **Letër Informat** | | |
| Nr. i Zyrës:<br>Br. Kancelarije:<br>Room No: | 3 | Lokacioni:<br>Lokacija:<br>Extencion: | Kamenicë | Data: **25/02/2025**<br>Datum:<br>Date: | **Nr7** |

# Letër Informat

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor/ Udhëheqësi i Sektorit të Urbanizmit/, (dokumentacioni është pranuar me datë 25/02/2025 dhe është hartuar me datë 25/02/2025), ka shqyrtuar kërkesën **Sh07-351/01-0004535/25** datë **25/02/2025 Tasneem AG.LLC/ Shqiponjë Bashkim Pira** për caktimin e kushteve ndërtimore për vendosjen e trafos elektrike, gabariti i objektit **(3.00x3.00m)** me **S=9 m²** në parcellën kadastrale, nr. **P-71107063-00977-1** e evidentuar në çertifikatën **nr. 367/2025** të datës **25/02/2025** , ZK. Poliqkë me sipër. S=187246m², pronari/poseduesi Komuna e Kamenicës për kyqjen e objektit depo bujqësore ku planifikohet të ndërtohet në parcellën kadastrale **P-71107063-00987-0, 0988-0,** Në lidhje me këtë ju informojm se , pas verifikimit të dokumentacionit të cilin ne e disponojmë, dokumentacionit që nga pala na është ofruar si dhe bazuar në ligjet që janë në fuqi të cilat e rregullojnë këtë lëmi u konstatua se:



Parcela kadastrale **P-71107063-0977-1** e gjendet në kuadër të **Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), Vendimi i Kuvendit Komunaltë Kamenicës Sh. 01 nr. 06. 15525 datë 08.05.2014,** Sipas ekstraktit të nxjerrur nga **PZHK** parcela e lartëcekur është **Tokë ndërtimore, Kullos, Pyje të Larta dhe Rrugë** sshih pjesën e nxjerrur nga plani Plani Zhvillimor Komunal(**PZHK**) **(Destinimi i Sipërfaqeve)** faqe **488,** harta **nr. 56, (Infrastruktura e transportit)** faqe **446,** harta **nr. 41, (Rrjeti rrugor)** faqe **447,** harta **nr. 42**

Duke u bazuar në kërkesën e lartëcekur, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, sygjeron që pala;
paraprakisht të siguroj aprovimin nga kuvendi komunal per dhenjen e parceles ne shfrytezim, pastaj ti propozoj organit kompetent **Kushtet Ndërtimore** me Projekt Konceptual konform Ligjit **Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor**, dt. 31 korrik 2013 neni **21 paragrafi 5** Kushtet Ndërtimore, **Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110** neni **18, Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017** dhe shtojces nr. **1**, duke e respektuar nenin **10** paragrafin **1** nënparagrafi **1.1 si dhe**
**Udhëzimet Admnistrativ Nr. 08 /2017** të datës 09. 06. 2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

**Vërejtje**:
Pas kompletimit të dokumentacionit në mënyrë grafike dhe digjitale (**CD** ose **DVD** të ruajtur në **DWG** sipas **Kosova REF**), pala duhet ti drejtohet **DUPH**-së të Kamenicës për këtë kërkesë, e cila është organi i vetëm kompetent për aprovimin e Kushteve Ndërtimore.

Përgjegjës për Planifikim

Master i sh.ark. Mehmet R.THAÇI

DREJTORI

Uran Berisha